TITULLI NË ORIGJINAL: أربعيون حديثا في العقيدة

TITULLI NË GJUHËN SHQIPE: DYZET HADITHE RRETH BESIMIT (AKIDES)

AUTOR: ISLAMWEB.COM

PËRKTHEU: HOXHË SHPEND ZENELI

BOTIMI: I PARË – JANAR 2018 - SHKUP

Të drejtat janë të rezervuara, për web faqen www.albislam.com, nuk lejohet asnjë kopjim, e as botim pa leje paraprake nga stafi faqes.

KRIJIMI I GJITHËSISË

HADITHI I PARË

Imran ibn Husajn, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, rrëfen dhe thotë: "Isha tek i dërguari, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, kur erdhën disa njerëz nga fisi Temim, e u tha atyre: "O Beni Temim! Gëzohuni (për një sihariq për ju)!" Ata i thanë: "Na dhe sihariq, por tani na jep diçka (pasuri)." Pastaj erdhën njerëz nga Jemeni, të cilëve ai u tha: "O populli i Jemenit! Pranoni sihariqet, pasi Beni Temimët nuk i pranuan ato." Jemenasit i thanë: "I pranuam, kemi ardhur tek ti që të mësojmë fenë, e të të pyesim për fillimin e krijimtarisë; si ka qenë?" (Ai u përgjigj): (Në fillim) ka qenë vetëm Allahu dhe nuk kishte asgjë tjetër përveç Tij dhe Arshi (Froni) i Tij ishte mbi ujë. Më pas Allahu krijoi qiejt e tokën, dhe Ai shkroi gjithçka në Libër."[1]

Kuptimi i përgjithshëm i hadithit

I dërguari i Allahut, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, e kishte zakon që gjatë ndejave të tija të mirret edhe me mësimdhënie shokëve të tij, sidomos të rinjtë të cilët sapo kishin pranuar fenë, apo grupet që vinin nga vendet e largëta.

Kur tek ai erdhi një grup i fisit Temim, i dërguari i Allahut, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, i përgëzoi me atë që kishte përgatitur Allahu për të devotshmit, e u tha: "Pranoni sihariqin", kështu që priste prej tyre që ta pyesin për fillimin e kësaj bote, se si ka filluar krijimi? Pos që ata ishin të interesuar për interesin e tyre afatshkurtër, shikonin vetëm për gjërat materiale, e i dërguari i Allahut, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, ua ktheu shpinën atyre, dhe iu drejtua grupit tjetër që kishin arritur nga Jemeni, e u tha atyre: "Pranoni sihariqin, o banorë të Jemenit, pasi që fisi Temim nuk e pranoi", kështu që ata e pranuan, dhe e pyetën për fillimin e krijimit, se si ka filluar, e si është krijuar kjo botë?

[1] Transmeton Buhariu (9/124) hadithi me numër (7418).

www.albislam.com

I dërguari i Allahut, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, ju tregoi atyre se Allahu është Krijuesi i gjithësisë, dhe se Allahu ka qenë e nuk ka pasur asgjë para Tij, Ai krijoi çdo gjë nga asgjëja, Ai filloi krijimin e qiejve dhe të tokës, e Arshi i Tij ishte në ujë.

I dërguari i Allahut, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, nuk u tregoi atyre për fillimin e krijimit të Arshit, e as për krijimin e ujit, për arsye se qëllimi i pyetësve ishte për fillimin e krijimi të botës, e jo për krijimin në përgjithësi.

Dhe i dërguari i Allahut, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, sqaroi se çdo gjë që ka të bëjë me këtë botë Allahu e rreshtoi në 'Lehvi Mahfudh'.

Disa dobi të hadithit

1. Allahu është i Pari, para të Cilit nuk ka gjë tjetër.
2. Se çdo gjë përpos Allahut është e krijuar nga asgjëja.
3. Se Arshi dhe uji i paraprinë krijimit të qiejve dhe të tokës.
4. Se Allahu nuk është i nevojshëm për Arshin, por Arshi dhe çdo gjë tjetër pos Arshit janë nevojtarë për Të.
5. Pohimi i atributit të krijimtarisë për Allahun e Madhëruar.
6. Besimi në caktimin e Allahut, se Allahu ka regjistruar me dijen e Tij për gjithë atë që ka qenë, për gjithë atë se çfarë do të ndodhë në regjistrin e Tij.

www.albislam.com

ISLAMI FE E NATYRSHMËRISË NJERËZORE

HADITHI I DYTË

Ebu Hurejra, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, tregon se i dërguari i Allahut, *paqja dhe bekimi i Tij qofshin mbi të*, ka thënë: "Çdo foshnjë lind në natyrshmërinë (fenë e Allahut), më pas prindërit e bëjën çifut, të krishterë apo zjarrputist, njejtë sikur që kafsha lind kafshën pa të meta, e vëreni se është me vesh të këputur."[2]

Ebu Hurejra, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, më pas tha: "Poqëse dëshironi lexoni ajetin: "**krijimtarinë e Allahut, sipas të cilës Ai i ka krijuar njerëzit. S'ka ndryshim në krijimtarinë e Allahut**." Sureja Rum, 30.

Fjalë të panjohura

Fitrah: Është ngulitja e besimit për ekzistimin e Allahut dhe njohjen e njëshmërisë së Tij në zemër. Njashtu kanë thënë fitrah është: Gatishmëria dhe dispozicioni për të pranuar ftesën e besimit.

Kuptimi i përgjithshëm i hadithit

Ky hadith flet për një çështje me rëndësi të madhe, e që është se në origjinë njeriu e ka besimin në Allahun e cila shprehet me fjalën 'fitrah', që në kuptimin etimologjik tregon se është një gjë e krijuar së bashku me njeriun dhe është vendosur në të, njejtë sikur që vendosen të gjitha gjymtyrët, dhe se njeriu del nga kjo natyrshmëri si pasojë e efekteve të jashtme, që nga edukimi, mjedisi ku ai jeton, e arsimimi jo i duhur.

Gjendjen e njeriut kur ai lind në natyrshmëri të pastër i dërguari i Allahut, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, e ngjasoi me shembullin e një kafshe, e cila është e plotë në fizionominë e saj, pa të meta, pasi që të jetë rritur i prejnë asaj veshët, kështu e ndryshojnë formën në të cilën ajo ishte krijuar, njashtu devijimet që i ekspozohen njeriut në natyrshmërin e tij, si pasojë e një ndikimi të jashtëm. Poqëse të kishte caktuar Allahu që

[2] Transmeton Buhariu (2/94) hadithi me numër (1358). Dhe Muslimi (4/2047) hadithi numër (2658)

www.albislam.com

njeriu të jetonte i vetëm, e të edukohet i vetëm pa ndonjë ndikim të jashtëm, do të jetonte si një besimtar, njohës i Allahut.

Disa dobi të hadithit

1. Oligimi i parë i njeriut është njëshmëria e Allahut, dhe atë se besimi në Allahun është shprehur me fjalën 'fitrah' e cila është përqendruar në shpirtin e njeriut, e çrregullimi që i ndodh njeriut është në të bërit shirk Allahut e marrjen për zot të tjerë pos Tij. Për këtë, gjëja e parë me çfarë duhet drejtuar atij që është në këtë gjendje është njëshmëria e Allahut dhe mohimi i politeizmit, ndërsa kush ka çrregullim në çështjen e ekzistimit të Allahut, apo të jetë një njeri ateist, gjëja e parë me çfarë duhet drejtuar atyre është argumentet e ekzistimit të Allahut.

2. Natyrshmëria e pastër nuk mund të zhduket, por ajo mbulohet e fshehet me vepra të kufrit e të shirkut, pasi që të hiqen ato vepra e pasojat e tyre, kthehet njeriu në natyrshmërinë tij, dhe beson në Zotin.

3. Të kapurit për fenë e vërtetë është domosdoshmëri njerëzore, nuk mundet që njeriu të jetë i shkujdesur e ta refuzon atë, apo ta fshijë nga lista e prioriteteve, dhe atë për shkak se është ngulitur thellë në zemrat e tyre kthimi tek Ai, që ta adhurojnë, ta madhërojnë, tek Ai të kërkojnë mbështetje për sprovat, belatë e fatkeqësitë që i godasin.

4. Fëmijët e muslimanëve janë të shpëtuar ditën e Kiametit, që është një prej çështjeve të konfirmuara me konsensus, ndërsa, sa i takon fëmijëve të paganëve të cilët kanë vdekur para se të arrijnë bylykun, mendimi më i saktë është se ata vdesin në fitrah, para se ajo të ndryshohet. Imam ibn Haxheri për fëmijët e paganëve ka thënë: "Ata janë në xhenet."

Neveviu ka thënë: "Ky është mendimi më i saktë dhe i zgjedhur, të cilin mendim e kanë edhe shumë dijetarë, duke u mbështetur në fjalën e Allahut: "**Na nuk dënojmë (askend) para se të dërgojmë pejgamber!**" Isra, 15.

Njashtu prej argumenteve është edhe hadithi i shënuar nga Buhariu transmetuar nga Semure ibn Xhundub, se i dërguari i Allahut, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, në hadithin e gjatë të ëndrës mes tjerash ka thënë: "Ndërsa personi me trup të gjatë i cili po qëndronte në kopsht, ai është Ibrahimi, alejhi selam, e fëmijët rreth tij janë fëmijët të lindur në fitrah. I thanë: O i dërguar i Allahut, e fëmijët e paganëve? I dërguari i Allahut, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, tha: "Edhe fëmijët e paganëve."

5. Njohja e çështjes; shpëtimit të fëmijëve nga prindërit paganë në ahiret, nuk nënkupton se ata dallojnë në dispozita nga baballarët e tyre që edhe në dynja.

www.albislam.com

TEUHIDI, OBLIGIMI I PARË PËR NJERËZIMIN

HADITHI I TRETË

Ibn Abasi, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, përcjell e thotë: Kur i dërguari i Allahut, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, dërgoi Muadh ibn Xhebelin tek banorët e Jemenit, i tha: "Ti po shkon tek një popull që janë ithtarë të librit (çifut e të krishterë). Le të jetë gjëja e parë në çrafë do t'i ftosh ata njëshmëria e Allahut të Madhëruar. Në qoftë se ata binden në këtë, atëherë tregoju atyre se Allahu ua ka obliguar faljen e namazit pesë herë gjatë ditës e natës. Në qoftë se ata binden në këtë, atëherë tregoju se Allahu ua ka bërë obligim të paguajnë zeqat nga pasuria e tyre, mirret nga të pasurit e u jipet të varfërve prej tyre."[3]

Kuptimi i përgjithshëm i hadithit

Ky hadith flet për obligueshmërinë e teuhidit, dhe se është gjëja e parë me çfarë ju drejtohet ithtarëve të librit, kur i dërguari i Allahut, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, porositi Muadhin që të fton banorët e Jemenit, të cilët atëkohë ishin çifutë e të krishterë, t'i fton në teuhid së pari, që është të njësohet Allahut në veprat e Tij, në adhurim dhe në Emrat dhe atributet e Tija.

Sikur që hadithi tregon edhe për rëndësinë e fillimit me teuhid, duke mos iu drejtuar njerëzve me ndonjë obigim tjetër derisa ata së pari të besojnë .

Hadithi njashtu tregon rëndësinë e dërgimit të dijetarëve në vende të ndryshme për t'i mësuar njerëzit, për njohjen e dispozitave të fesë, si dhe rëndësia e njohjes së gjendjes atyre të cilëve u drejtohet thirrja nga ana e thirrësit apo dijetarit, duke filluar nga ajo që është më me rëndësi në thirrje dhe kumtim të fesë.

[3] Transmeton Buhariu (9/114) hadithi me numër (7371). Dhe Muslimi (1/51) hadithi numër (19).

www.albislam.com

Dobi të hadithit

1. Gjëja e parë e cila përcaktohet gjatë fjalimit me njerëzit është teuhidi, për arsye se është obligimi i parë që Allahu e bëri për robërit e Tij.
2. Teuhidi është kusht i pranimit të veprave të mira, andaj nuk pranohet asnjë vepër e mirë kushdo që të vepron, përderisa nuk beson në njëshmëri, apo përderisa të mos i prish bazat apo shtyllat e teuhidit.
3. Nuk gjykohet për një njeri se është musliman, derisa ai të shqipton dy dëshmitë. Mbështetur në hadithin e ibn Abasit, në një transmetim tjetër: "Le të jetë gjëja e parë në çfarë do t'i ftosh; dëshmija se nuk ka të adhuruar tjetër me meritë përveç Allahut dhe se unë jam i dërguar i tij."
4. Shqiptimi i dy dëshmive nuk është i mjaftueshëm, por, ajo dëshmi duhet të pasohet me vepra të mira, duke kryer obligimet, pasi që i dërguari i Allahut, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, nuk e autorizoi Muadh ibn Xhebelin vetëm të fton në teuhid, por e urdhëroi që t'ua mëson atyre farzet e fesë dhe dispozitat e saj.

www.albislam.com

VLERA E TEUHIDIT

HADITHI I KATËRT

Uthman ibn Afani, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, përcjell se i dërguari i Allahut, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, ka thënë: "Kush vdes duke e ditur fjalën La ilahe il Allah (Nuk ka Zot tjetër pos Allahut) hyn në xhenet."[4]

Kuptimi i përgjithshëm i hadithit

Vlera e teuhidit është aq saqë konsiderohet bazë dhe thelb i fesë, gjithçka tjetër ndërtohet mbi të, e jo që teuhidi të ndërtohet apo të jetë i ngritur mbi diç tjetër. Kush vdes me teuhid, ai ka vdekur me thelbin dhe bazën e fesë, për këtë teuhidi ka aq vlerë sa i jep të drejtë njeriut që të hyjë në xhenet, e të fiton kënaqësinë e Allahut.

Kuptimi i teuhidit nuk përkufizohet vetëm se në shqiptimin e fjalëve pa ditur kuptimin e tyre, e pa të vepruarit sipas mësimeve të tij, për atë se feja është besim (akide) dhe dispozita (sheriat), e nuk arrihet shpëtimi në botën tjetër pos nëse realizohen të dyjat se bashku.

Disa dobi të hadithit

1. Vlera e teuhidit.
2. Shpëtimi për atë që vdes me teuhid.
3. Dituria mbi kuptimin e teuhidit është kusht i pranimit, dhe përfitimit prej tij në ahiret.
4. Shpëtimi është lidhur ngusht me diturinë mbi teuhidin dhe të verpuarit sipas mësimeve të tij, e jo vetëm se shqiptimi me gojë.

[4] E shënon Muslimi (1/55) hadithi numër (26).

MËKATI MË I MADH E MË I SHËMTUAR

HADITHI I PESTË

Abdullah ibn Mesudi, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, përcjell e thotë: Kam pyetur të dërguarin, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-: Cili është mëkati më i madh ndaj Allahut? Tha: "T'i bësh Allahut rival, kurse Ai është i Cili të ka krijuar." Thashë: Kjo vërtetë është një mëkat shumë i madh. E pyeta: Më pas cili? Tha: "Ta mbysësh fëmijën tënd nga frika se do të ushqehet së bashku me ty." E pyeta: Pastaj cili? Tha: "Zinaja me bashkëshorten e fqiut."[5]

Kuptimi i përgjithshëm i hadithit

Sahabët, *Allahu qoftë i kënaqur me ta*, pyetnin të dërguarin, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, për mëkatet, e për kategoritë e tyre, që ata t'iu largohen mëkateve, ta dinë të keqen e mëkateve e të tërheqin vërejtjen prej tyre.

Në këtë kuadër, edhe sahabiu i nderuar, Abdullah ibn Mesudi, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, pyeti të dërguarin, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, për mëkatin më të madh, pra: mëkatin më të rëndë, më të keq, e i dërguari i Allahut, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, i tregoi se mëkati më i madh është shirku, që është; t'i bësh Allahut ortak, të cilin ai e adhuron, e kthehet tek ai, atij i mbështetet, e ta braktis adhurimin e Allahut, i Cili e ka krijuar dhe e ka furnizuar.

Më pas, Abdullah ibn Mesudi, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, e pyeti për mëkatin i cili vijon pas shirkut, për nga shëmtimi dhe madhësia? I tha: "Kur njeriu të vret fëmijën e tij, nga frika se do të ushqehet e do të pijë së bashku me të", kjo frikë e cila buron nga një bindje e prishur, sikur Allahu të mos kishte garantuar riskun për robërit e Tij, njejtë buron edhe nga

[5] Transmeton Buhariu (6/18) hadithi me numër (4477). Dhe Muslimi (1/90) hadithi numër (86).

www.albislam.com

zemra e ngurtë, pasi që mësyn të vret pjesën e trupit të tij, frytin e zemrës së tij, gjë që bën që ky krim të renditet i dyti prej krimeve më të mëdha e më mizorë tek Allahu.

Më pas, Abdullah ibn Mesudi, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, e pyeti për mëkatin i cili vijon pas këtyre dy mëkateve, e i dërguari i Allahut, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, iu përgjigj se ai mëkat është; zinaja me bashkëshorten e fqiut, ky krim i shëmtuar bëhet i qartë pasi që fqiu ndihet i sigurtë për nderin e fqiut të tij, andaj shkelja e nderit konsiderohet një mashtrim i të drejtës së fqiut, të cilën të drejtë Allahu dhe i dërguari i Tij e konsideruan shumë të madhe.

Dobi të hadithit

1. Llojlloshmëria e mëkateve për nga mizoria e shëmtueshmëria.
2. Shirku është mëkati më i madh në përgjithësi.
3. Sqarimi i realt i shirkut dhe se shirk është të vendosësh diç tjetër ortak me Allahun, në qenien e Tij, veprat, emrat dhe atributet e Tija.
4. Allahu është meritor të adhurohet pasi që Ai është Krijuesi i cili i krijoi shpirtrat e i ngjalli ato.
5. Çdo lloj adhurimi i cili kryhet ndaj dikujt tjetër përveç Allahut është haram.
6. Të vendoset Allahu në të njejtën pozitë me dikë tjetër është haram.
7. Vlera e teuhidit dhe se ky është prej adhurimeve më të mëdha.

www.albislam.com

CILËSITË E HAVARIXHËVE

HADITHI I GJASHTË

Ebu Said el Hudriu, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, përcjell e thotë: "U ngrit një burrë me sy të futur thellë, me fytyrë me kocka të dala, me ballë të lartë, me mjekër të dendur, me kokë të rruar dhe me një copë të hedhur në bel të përveshur dhe tha: "O i Dërguari i Allahut! Ki frikë Allahun!" Pejgamberi, alejhi selam, tha: "O i mjerë! A nuk jam unë nga gjithë njerëzit në tokë që meritoj më shumë të kem frikë Allahun?!" Pastaj ai njeriu u largua. Halid Ibn Velidi tha: "O i Dërguari i Allahut! A t'ia këpus qafën?" Pejgamberi, alejhi selam, tha: "Jo, mbase fal namaz." Halidi i tha: "Të shumtë janë ata që falin namazin dhe që gjuha u flet atë që nuk është në zemrën e tyre." I Dërguari i Allahut tha: "Unë nuk jam urdhëruar (nga Allahu) të gërmoj në zemrat e njerëzve, ose t'u çaj gjoksin atyre." Pastaj Pejgamberi, alejhi selam, pa drejt atij (burri) ndërsa po largohej dhe tha: "Nga pasardhësit e këtij njeriu do të vijnë njerëz që do të këndojnë Kuran vazhdimisht dhe për mrekulli, por nuk do t'ua kalojë gurmazin (nuk do t'u burojë nga shpirti, nuk do ta kuptojnë dhe nuk do ta zbatojnë në jetë). Ata do të dalin prej feje siç fluturon shigjeta prej harkut. I vrasin muslimanët e lënë të qetë paganët. Po të jetoja në kohën e tyre, do t'i vrisja siç u vra populli i Adit."[6]

Kuptimi i përgjithshëm i hadithit

Të qëndrosh në islam ashtu siç e ka zbritur Allahu, siç e kumtoi i dërguari i Tij, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, dhe se si e kanë praktikuar shokët e tij, *Allahu qoftë i kënaqur prej tyre*, është një kërkesë fetare, e një synim profetik në çfarë thërret edhe vet Kurani. Njashtu i dërguari i Allahut, ka nxitur për një gjë të tillë kur thërriti që t'i përmbahemi traditës së tij, e tërheqi vërejtjen nga dalja prej rrugës së tij, e ndjekjen e rrugës së të dalëve e të devijuarve.

[6] Transmeton Buhariu (9/127) hadithi me numër (7432). Dhe Muslimi (2/741) hadithi numër (1064).

www.albislam.com

Në këtë hadith i dërguari i Allahut na e tërheq vërejtjen nga një grupacion që do të del më pas (kohës së tij), ata kanë veçori të adhurimit e asketizmit, por, janë të dobët në dije, kanë kuptim të gabueshëm, të devijuar në meditim e pasqyrim të çështjeve, lexojnë Kuranin, por, pa kuptuar synimet e tij e pa kuptuar mësimet e tija. Kjo ka të bëjë në aspektin terminologjik, ndërsa në aspektin praktik ata pozicionohen në armiqësi me umetin islam, duke i shpallur ata për jobesimtarë, e duke i vrarë, ndërsa prej tyre shpëtojnë jobesimtarët kundërshtarë. Në disa pikpamje vje në pah rreziku i madh prej tyre, sherri i pafund, sa që bëri që i dërguari i Allahut, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, të zotohet se po t'i arrinte do t'i luftonte, sikur që u luftua populli i Adit, ky njëherit është një urdhër për umetin që t'i lufton ata, të parandalojnë sherrin e tyre, e të mos mashtrohen me pamjet e praktimit të adhurimeve.

Dobi të hadithit

1. Vërtetësia e profetësisë së tij, me shfaqjen e grupacioneve që bien në kundërshtim me fëne islame.
2. Përshkrimi i cilësive më kryesore të havarixhëve në aspektin e dijes: të dobët në dije, e në kuptim.
3. Përshkrimi i cilësive më kryesore të havarixhëve në aspektin praktik të fesë: vrasjen e muslimanëve duke i lënë të qetë politesitët.
4. Prej cilësive të tyre është edhe shmangia nga suneti i të dërguari, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-.
5. Konfirmimi i cilësisë së të dërguarit, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, për veten e tij, se ai është njeriu besnik i Allahut.
6. Mbrojtja e të dërguarit, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, nga mëkatet.

www.albislam.com

BESIMI NË KADER

HADITHI I SHTATË

Abdullah ibën Mes'udi, *Allahu qoftë i kënaqur prej tij*, thotë: i Dërguari i Allahut na ka treguar, e ai është i sinqerti dhe i vërteti:

"Çdo kujt, krijimi i tij i mblidhet në barkun e nënës dyzet ditë në një pikë. Pastaj bëhet pikë gjaku i ngjizur, po aq. Pastaj bëhet copë mishi, po aq. Pastaj dërgohet tek ai një melek që fryn (në fetus) shpirtin dhe urdhërohet me katër gjëra: me shkrimin e riskut (furnizimit) të tij, kohëzgjatjen e jetës së tij, veprat e tij dhe a do të jetë i lumtur apo i dëshpëruar. Pasha Allahun, përpos të Cilit zot tjetër nuk ka! Ndonjëri prej jush do të punojë punë të banorëve të Xhenetit derisa të mos mbetet ndërmjet tij dhe Xhenetit vetëm sa një kut. Pastaj e mund ajo që është shkruar, fillon të punojë punë të banorëve të zjarrit dhe do të hyjë në të. Një tjetër do të punojë punë të banorëve të zjarrit derisa të mos mbetet ndërmjet tij dhe Xhehenemit sa një kut, pastaj e mund ajo që është shkruar, fillon të punojë punë të banorëve të Xhenetit dhe hyn në të."[7]

Kuptimi i përgjithshëm i hadithit

Allahu i Madhëruar begatoi njeriun me përkujdesin e Tij që prej fillimi e deri në fund, që kur njeriu është në barkun e nënës së tij, rrokulliset në dhunti të Allahut e përkujdesin e Tij, e krijon atë Allahu, e zhvillohet që prej një pikë uji deri në një gjak të ngjizur e prej gjakut të ngjizur në një copë mishi, që pasi që të kompletohet fizionomia e tij Allahu i jep shpirtin, pasi që të ketë përfunduar katër muaj të plotë, e i vije meleku për këtë qëllim, dhe urdhërohet që t'ia regjistron riskun, afatin e jetës dhe ecurinë e tij si një i keq apo i lumtur.

Ky lloj regjistri nuk e përcakton fatin por e përshkruan atë, pra, atë që e regjistron meleku nuk është gjë tjetër pos dituria e Allahut mbi njeriun, dhe se si do të jetë jeta e tij

[7] Transmeton Buhariu (9/135) hadithi me numër (7454).

www.albislam.com

përnga lumturia e dëshpërimi, e sidomos përfshin se si do të jetë natyrshmëria e krijimtarisë së tij, mashkull apo femër.

Ky hadith flet qartë për ndryshimet e gjendjes së njeriut në jetën e tij, përderisa ai ecën në rrugën e vërtetë e të saktë, ndodh që ai të ndërron e të merr rrugën e shkatërrimit e devijimit e të vdes në të, dhe e kundërta, dikush kalon gjithë jetën e tij në mëkate e punë të këqija, mirëpo merr vendimin e duhur në çastet e fundit të jetës, pendohet e kthehet tek Allahu.

Disa dobi të hadithit

1. Dituria e Allahut përfshin çdo gjë.
2. Përkujdesi i Allahut për njeriun në çdo etapë të jetës së tij.
3. Regjistrimi i dijes së Allahut në libër të veçantë.
4. Autorizimi i melaqeve për fryerjen e shpirtit tek bijtë e Ademit, dhe regjistrimin e veprave të tyre.
5. Njeriu në skaje të jetës së tij ndryshon në të mirë e në të keqe.
6. Përfundimi është përcaktuese, në kufër apo iman.
7. Përgjegjësia e njeriut ne veprat e tija.
8. Pendimi shlyen gjitha mëkatet e mëhershme.
9. Nëse njeriu vdes në kufër, i shkatërrohen veprat e tija të mira.

www.albislam.com

POZITA E VEPRAVE PREJ IMANIT

HADITHI I TETË

Ebu Hurejra, *Allahu qoftë i kënaqur prej tij*, përcjell se i dërguari i Allahut, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, ka thënë: "Imani është shtatëdhjetë, ose gjashtëdhjetë e ca pjesë, më a larta është fjala; La ilahe il Allah (Nuk ka Zot tjetër përveç Allahut), e më e ulta është të largosh një pengesë nga rruga, edhe turpi është një pjesë e imanit."[8]

Kuptimi i përgjithshëm i hadithit

Me këtë hadith deshi i dërguari i Allahut, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, që të jep një perceptim të përgjithshëm të imanit, se imani ka disa shtylla e ligje, se imani përfshin vepra të mira të zemrës, vepra të gjymtyrës dhe fjalë. Përmendi gradën më të lartë të imanit që është teuhidi, dhe gradën më të ultë, që shumë njerëz nuk i japin rëndësi se është një prej veprave të mira, sikur që është largimi i një pengese prej rrugës. Më pas përmendi turpin për të aluduar në atë se çfarë ka mes këtyre dy prej veprave të mira, që të gjitha bëjnë pjesë në iman.

Dobi të hadithit

1. Imani definohet me të gjitha ritet fetare, qoftë ato vepra me zemër, me gjymtyrë apo me gjuhë.
2. Prej riteve e farzeve më të larta të imanit, është fjala La ilahe il Allah, me sinqeritet dhe bindje.
3. Se "largimi i pengesës nga rruga" e njerëzve është prej imanit.
4. Se "turpi" është prej imanit, është moral që e pengon njeriun të veprojë punë të liga e të këqija.
5. Pozitat e ndryshme të veprave prej imanit, prej tyre ka që janë më së larti në grada të imanit, e prej tyre që janë në gradë më të ulët, e tjera që janë mes tyre.
6. Vlera e dëshmisë së teuhidit, dhe se është pjesë e vyeshme e imanit.
7. Se veprat janë pjesë e nocionit iman, dhe kuptimit të realt të imanit.

[8] Transmeton Muslimi (1/63) hadithi numër (35).

www.albislam.com

IMANI PAKOHET ME MËKATE

HADITHI I NËNTË

Ebu Hurejra, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, përcjell se i dërguari i Allahut, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, ka thënë: "Zinaqari nuk është besimtar gjatë kohës që kryen marrëdhënie jashtëmartesore, ai që pi alkool nuk është besimtar gjatë kohës që pi alkool; hajduti nuk është besimtar gjatë kohës që vjedh."[9]

Kuptimi i përgjithshëm i hadithit

Imani është si një pemë të cilën e rrit dhe e zhvillon uji, i shton asaj frytet e fuqinë, e ruan atë nga vyshkja e tharrja, e cila pemë shuhet e zhduket poqëse pakohet ushqimi i saj, njejtë është edhe imani, rritet, forcohet me vepra të mira, ngritet në gradat e larta të imanit si frika prej Allahut, shpresimi tek Ai, dashuria ndaj Tij, e shuhet e prishet me kufër e shirk, dobësohet e venitet me mëkate e punë të liga, siç është vjedhja, zinaja, konsumimi i alkoolit, e mëkate të tjera.

Pra, lidhshmëria mes imanit dhe veprave është lidhje direkte dhe e ndërsjelltë , ai shtohet e forcohet me punë të mira, dobësohet e venitet me mëkate e punë të liga. Kush dëshiron të shton imanin e tij e ta forcon atë, ai duhet t'i përkushtohet veprave të mira, e të largohet prej veprave që janë shkatërruese.

Në këtë hadith, i dërguari i Allahut, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, na sqaron për efektin e mëkateve mbi imanin, se si ato e dobësojnë saqë nuk mbetet prej tij diç pos një pjese të vogël, e gjithë kjo si shkak i mëkateve. Andaj, muslimani i cili dëshiron të ruan imanin e tij, ta mban lartë të ngritur, duhet që të jetë i angazhuar me punë të mira, e të largohet prej mëkateve, kështu ai gjen shpëtim në dynja e në ahiret.

[9] Transmeton Buhriu (3/163) hadithi numër (2475).

www.albislam.com

Dobi të hadithit

1. Imani pakohet me veprimin e mëkateve.
2. Shpalosja e mëkateve nuk konsiderohet kufër.
3. Zinaja, pirja e alkoolit dhe vjedhja konsiderohen mëkate të mëdha.
4. Mohimi i të qenurit besimtar në hadith ka për qëllim mohimin e imanit të plotë e jo edhe gjithë imanin e themelin e tij, duke u argumentuar për këtë me konsensusin e të parëve se mëkatet nuk e nxjerrin njeriun prej fesë, përpos nëse ai ato i bën hallall.

VARRI
VENDBANIMI I PARË I AHIRETIT

HADITHI I DHJETË

Imam Ahmedi, *Allahu e mëshiroftë* shënon hadithin e Berai bin Azib, *Allahu qoftë i kënqur prej tij*, se ka thënë:

"Dolëm me të dërguarin, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, me xhenazen e një burri prej ensarëve (medinasve). Pasi e varrosëm, u ul i dërguari i Allahut në drejtim të Kiblës dhe ne u ulëm rreth tij, sikur mbi kokat tona të qëndronin zogj (u ulëm qetë). Në dorë i dërguari, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, kishte një shkop, me të cilin gërvishtte tokën. Pastaj filloi të shikojë në qiell dhe në tokë, e ngriti dhe e uli shikimin e tij tri herë, dhe tha: "Kërkoni ndihmën e Allahut nga ndëshkimi i varrit."

Pastaj tha: "Kur njeriu besimtar gjendet në momentin e ndarjes nga kjo botë dhe pritjes së ahiretit, i zbresin atij melaqe nga qielli me fytyra të bardha si dielli, me vehte kanë qefinë nga qefinët e xhenetit dhe erëra të mira nga ato të xhenetit. Ata i ulen atij me një gjërësi sa i sheh syri. Pastaj vjen meleku i vdekjes, alejhi selam, i cili ulet tek koka e tij dhe thotë: "O shpirt i mirë, dil për në mëshirën e Allahut dhe kënaqësinë e Tij". Pastaj shpirti del me një lehtësi të tillë, siç del pika e ujit nga gryka e shtëmbës, dhe meleku i vdekjes e merr atë. Këtë shpirt e përshëndesin të gjithë melaqet e qiellit dhe të tokës, i hapen atij dyert e qiellit dhe secili prej këtyre grupeve të melaqeve që rrijnë në këto dyer, i luten Zotit që ta ngrejë këtë shpirt edhe më lart. Në momentin kur meleku i vdekjes ia merr shpirtin, melaqet e mëshirës ia rrëmbejnë atij këtë shpirt sa hap e mbyll sytë, dhe nuk e lëshojnë atë derisa e vendosin në atë qefin dhe në ato erëra dhe del nga kjo një erë misku - më e mira erë që gjëndet në sipërfaqen e tokës.

Kështu melaqet e mëshirës ngrihen me këtë shpirt lart në qiell. Rrugës këta takojnë grupe melaqesh të cilët thonë: "Kush është ky shpirt i mirë?" U përgjigjen: Është filani i biri i filanit, duke e përmendur me emrat më të bukur me të cilët e kanë thirrur në dynja. Kështu shkojnë derisa të arrijnë në qiellin e dynjasë. Këtu kërkojnë që t'u hapet ky qiell, dhe ai

www.albislam.com

hapet. Melaqet që rrijnë në këtë qiell e shoqërojnë shpirtin deri në qiellin që vjen më pas dhe kështu deri sa të arrijnë në qiellin e shtatë. Allahu i Madhëruar thotë: "Shkruajeni librin e robit tim në Ilijjin (libër në të cilin shkruhen veprat e mira) pastaj i thuhet: "Kthejeni në tokë, se Unë ua kam premtuar atë, se nga ajo (toka) i krijova dhe tek ajo i kthej dhe prej saj do t'i ngrej përsëri në ahiret (ditën e Gjykimit)". Pastaj shpirti i kthehet në tokë.

Pasi shpirti është kthyer në trupin e tij ai ndjen zhurmën e hapave të atyre që ikin. Në këtë çast të vdekurit i vijnë dy melaqe dhe i ulen afër duke e pyetur: "Kush është zoti yt?" -ai përgjigjet: "Zoti im është Allahu". Pastaj thonë: "Cila është feja jote?" -thotë: "Feja ime është Islami". Pastaj pyesin: "Cili ishte ai burrë që ju dërgua juve?" - thotë: "Ai është i dërguari i Zotit" Melaqet e pyesin përsëri: "Si e kuptove ti këtë?" -thotë: "Lexova librin e Allahut dhe e besova atë". Thëret një thirrës në qiell: "Tha të vërtetën robi Im, prandaj shtroni atij prej shtrojeve të xhenetit dhe visheni atë me veshje të xhenetit dhe hapni atij derën tek xheneti". I vije atij nga era e tij dhe mirësitë e tija, gjithashtu i zgjerohet varri me një hapësirë aq sa sheh syri. Në këtë moment i vjen atij një burrë me pamje të hijshme me rroba të bukura dhe me erë të mirë dhe thotë: "Gëzohu me atë që të gëzon ty, përgëzohu me kënaqësinë e Zotit dhe xhenete në të cilat ka mirësi të përhershme", kjo është dita e cila të është premtuar. Pastaj shpirti i tij thotë: "Edhe ty të përgëzoftë Allahu me të mira, po kush je ti, fytyra jote sjell vetëm se mirësi?" thotë: "Unë jam puna jote e mirë. Për Zotin, vërtet ti ishe i shpejtë në mirësi dhe bindje ndaj Allahut dhe i ngadalshëm në mëkate. Prandaj Allahu të shpërbleftë me të mira".

Pastaj i hapet atij një derë nga zjarri dhe i thuhet: "Ky do të ishte vendi yt po të ishe prej mëkatarëve, e zëvëndësoi Zoti këtë vënd me këtë dhe i paraqitet xheneti. Ndërsa sheh se ç'ka atje, thotë: "Zoti im, shpejtoje kijametin me qëllim që të shkoj tek të afërmit e mi dhe pasuria ime". i thuhet atij: "Rri i qetë!"

Ndërsa mosbesimtarit, kur është në momentin e ndarjes nga kjo botë dhe afrimit për në ahiret, i zbresin atij melaqet nga qielli, me pamje të ashpër, me fytyra rë zeza. Në duar ata mbajnë pëlhura prej zjarri dhe i ulen atij në një distancë sa sheh syri. Pastaj vjen meleku i vdekjes i cili i ulet tek koka dhe i thotë: "O shpirt i keq, dil për tek zemërimi i Allahut".

Kështu del shpirti nga trupi i tij me vështirësi të madhe sikurse del boshti me kunja nga leshi i lagur. Ndërkohë e mallkojnë atë të gjithë melaiket midis qiellit dhe tokës dhe të gjithë melaqet në qiell, i mbyllen atij të gjitha dyert në qiell dhe melaqet që qëndrojnë në

këto dyer i luten Zotit që mos ta ngrejë këtë shpirt të keq pranë tyre. Kur meleku i vdekjes ia merr shpirtin, melaqet që zbritën nga qielli ia marrin atij nga duart sa hap e mbyll sytë dhe e vendosin në atë pëlhurën prej zjarri prej ku del një erë shumë e keqe, më e keqja erë që gjendet në faqen e dheut.

Pastaj ngrihen me të në qiell dhe kur kalojnë pranë çdo grupi melaqesh ata pyesin: "Ç'është ky shpirt i keq?" -i përgjigjen: "është filani i biri filanit" -dhe i përmendin emrat më të këqinj me të cilët e kanë thirrur në dynja. Kur arrijnë me të në qiellin e tokës dhe kërkojnë t'u hapet, ai nuk u hapet. Pastaj i dërguari i Allahut tha: "Nuk u hapen atyre dyert e qiellit dhe nuk hyjnë në xhenet aq sa hyn deveja në vrimën e gjilpërës". Thotë Allahu i Lartësuar: "Shkruajeni librin e tij në sixhxhin (libri ku shkruhen veprat e këqia), në vëndin më të ulët". Pastaj u thuhet: "Kthejeni robin tim në tokë, sepse unë nga ajo i krijova, tek ajo do t'i kthej dhe prej saj do t'i nxjerr përsëri". Pastaj hidhet shpirti derisa të shkojë në trupin e tij, dhe ai dëgjon hapat e shokëve kur largohen. Ndërkohë i vijnë atij dy melaqe me pamje të ashpër të cilët i ulen pranë dhe i thonë: "Kush është Zoti yt?" - Thotë: "Ah! Ah! Nuk e di". Pyesin përsëri: "Ç'mund të thuash për njeriun që u dërgua tek ju?" -ai nuk është i udhëzuar ndaj dhe s'e thotë dot emrin e tij. Dhe i thuhet: "Muhamedi!". - "Ah! Ah! -Thotë: "Nuk e di. Kam ndëgjuar njerëzit ta përmëndnin" dhe i thonë: "Nuk e dite, prandaj s'e the".

Dëgjohet më pas një thirrje nga qielli që thotë se gënjeu. Shtrojeni atë në shtroje prej zjarri. Hapet pastaj një derë prej dyerve të zjarrit kështu që atij i vjen afsh i nxehtë dhe erë kalbësire. Varri i ngushtohet derisa brinjët e krahërorit i ndërfuten me njëra-tjetrën.

Pastaj i afrohet një burrë me fytyrë të shëmtuar, me rroba të këqia dhe me erë të keqe dhe i thotë: "Përgëzohu me të keqen tënde. Kjo është dita jote e cila të është premtuar". -Po ty, të përgëzoftë Zoti me sherr, kush je ti? Burri i shëmtuar thotë: "U jam puna jote e keqe. Për Zotin ti ke qenë njeri i ngadalshëm në bindjen dhe adhurimet ndaj Allahut dhe i shpejtë ne vepra të këqia (mëkate), prandaj Allahu të shpërbleftë me të këqija!Pastaj goditet me një çekan hekuri, që sikur të goditej me të një mal do të bëhej pluhur. Kështu goditet me të dhe bëhet pluhur. Pastaj Allahu e kthen edhe një herë siç ishte dhe goditet përsëri dhe ai nxjerr një klithmë të fortë që e dëgjon çdo gjë përveç njerëzve dhe xhinëve. Dhe hapet një derë nga xhehennemi dhe i shtrohet shtroje prej xhehennemi dhe thotë: "O Zot mos e bë kijametin".[10]

[10] Transmeton Ahmedi në "Musned-in" e tij (30/499) hadithi numër (18534).

www.albislam.com

Kuptimi i përgjithshëm i hadithit

I dërguari i Allahut, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, në këtë hadith madhështor na sqaron fillimin e një rrugëtimi të njeriut që prej momentit të daljes së shpirtit e deri në vendbanimin e tij në varr, se si do të trajtohet varësisht prej veprave të tija gjatë jetës në këtë botë.

Pra, i dërguari i Allahut, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, tregoi se njerëzit janë dy llojësh; i devotshëm dhe i shthurur.

I devotshmi trajtohet me një kujdes të madh, me një nderim madhështor, pasi që i zbresin melaqet e mëshirës për t'i marrë atij shpirtin, i vijnë atij me pamje të mirë, me fytyra të ndritura e të bukura si dielli, i ulen atij për aq sa sheh syri, e i drejton sytë drejt tyre me qetësi e rehati, e meleku i vdekjes ia merr shpirtin, del me lehtësi të madhe, pa lodhje e pa vështirësi, melaqet nuk e lënë të vetëm, ngrihen me të së bashku deri në qiell në një shoqëri të mrekullueshme, i hapen atij dyert e qiellit, në çdo qiell përhapet lajmi i tij, habiten melaqet me erën e mirë të këtij shpirti të mirë, deri sa të arrijnë në qiellin e shtatë.

Prej aty, Allahu i Madhëruar i urdhëron melaqet e Tija që ta kthejnë këtë shpirt në tokë që të nderohet në varr, e regjistrohet libri i atij personi në një vend në qiellin e shtatë. Pasi që kthehet shpirti në tokë, melaqet e marrin në pyetje për Zotin, fenë dhe të dërguarin e tij, kështu që ai përgjigjet në mënyrë më të mirë, e thotë: Zoti im është Allahu, i dërguari im është Muhamedi, dhe feja ime është islami!

E Allahu urdhëron që t'i zgjerohet varri për këtë rob besimtar, e i vije atij nga era e xhenetit, çfarë bën që ai të shpreson që Allahu ta bën kiamet, që ai së shpejti të bashkohet me familjarët, e pasurinë e tij.

Ndërsa të keqit i vijnë melaqet e ndëshkimit me një pamje shumë të frikshme, me fytyra të nxirra, me vete mbajnë qefinet nga zjarri, i afrohen atij për aq sa sheh syri, ulet pranë kokës së tij meleku i vdekjes, e ia merr shpirtin, prej çfarë ai vuan shumë për shkak dhimbjes dhe vështirësisë që ndien, pasi që t'i del shpirti, e marrin melaqet e ndëshkimit, e qefinosin me qefin të zjarrit, prej të cilit del një erë e qelbur, e ngrisin atë deri në qiell, e nuk i hapen atij dyert e qiellit, Allahu i Madhëruar urdhëron melaqet që ta hedhin këtë shpirt në tokë, e i kthehet shpirti në trupin e tij, i vijnë melaqet dhe e marrin në pyetje, e pyesin kush

www.albislam.com

është Zoti yt, cila është feja jote e kush është i dërguari yt, ai nuk i di përgjigjet e thotë: Ah! Ah!

E Allahu u thotë melaqeve që t'i shtrojnë një shtrojë prej zjarri, e t'i hapin një derë drejt zjarrit, prej nga i vije atij nxehtësia e era e flakës, e kupton se çfarë e pret atë në ahiret, dhe e lut Allahun që të mos e bën kiamet!.

Dobi të hadithit

1. Vërtetësia e ndëshkimit dhe lumturisë në varr.
2. Ndëshkimi dhe përjetimi i begative ndodh edhe me shpirt dhe me trup.
3. Gjendja e ndryshme e njerëzve pas vdekjes, për shkak të veprave të ndryshme në dynja.
4. Ekzistimi i melaqeve.
5. Llojllojshmëria e melaqeve për nga profesioni i tyre.
6. Konfirmimi i bisedës mes Allahut dhe melaqeve.
7. Ekzistimi i librit 'ilijjin', ku janë të shënuara emrat e besimtarëve bamirës prej banorëve të xhenetit.
8. Shpirti mbetet edhe pas vdekjes.
9. Llojllojshmëria e pozitës së melaqeve.
10. Të besuarit në ringjallje.
11. Shpëtimi në ahiret arrihet me iman, dije të dobishme dhe vepra të mira.
12. Vërtetësia e pyetjeve për të vdekurin nga dy melaqet.

www.albislam.com

A E PA PROFETI, ALEJHI SELAM, ALLAHUN ?!

HADITHI I NJËMBËDHJETË

Ebu Dherri, *Allahu qoftë i kënaqur prej tij*, përcjell se ka pyetur të dërguarin e Allahut, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-: "A e ke parë Allahun? Është përgjigjur: "Ishte dritë, si mund ta shihja?!"[11]

Kuptimi i përgjithshëm i hadithit

Pasi që i dërguari i Allahut, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, u rrëfente shokëve të tij për ngjarjen e Miraxhit në qiellin e shtatë, dhe për çudirat që i kishte dëshmuar, se si Allahu i kishte folur atij me zë. Shumë njerëz u thelluan për gjatë kohë rreth çështjes se i dërguari i Allahut a e pa Allahun? Kjo ishte një pyetje që sahabiu i nderuar Ebu Dherr el Gifari, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, ia parashtroi të dërguarit, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, i cili i është përgjigjur se drita e kishte penguar ta sheh Allahun, e nuk kishte arritur ta sheh. Sikur që është vërtetuar kjo edhe në hadithe të tjera. Allahu shfaqjen e Tij para njerëzve e la për besimtarët në ditën e mahsherit dhe në xhenet, që shikimi në Allahun të jetë një dhunti më e madhe për ta.

Aisheja, radijAllahu anha, ka thënë: Kush thotë se Muhamedi, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, ka parë Allahun, ai ka gënjyer", pastaj lexoi ajetin: "**Shikimet nuk mund ta përfshijnë Atë, e Ai i përfshin shikimet e të gjithëve**..." Sureja En Am, 103.[12]

Dobi nga hadithi

1. I dërguari i Allahut, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, nuk e pa Allahun.
2. Kujdesi i sahabëve për çështjet e besimit.

[11] Transmeton Muslimi (1/161) hadithi numër (178).
[12] Transmeton Buhariu (9/116) hadithi numër (7380).

www.albislam.com

DYSHIMET RRETH BESIMIT

HADITHI I DYMBËDHJETË

Hisham ibn Urveh, përcjell nga babai i tij të ketë thënë: i dërguari i Allahut, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, ka thënë: "Vërtetë shejtani i vije ndonjërit prej jush dhe e pyet: Kush e krijoi qiellin? Ai përgjigjet: Allahu! Pastaj e pyet: Kush krijoi tokën? E ai përgjigjet: Allahu! E pastaj e pyet: Kush krijoi Allahun? Nëse has në këtë pyetje le të thotë: Kam besuar në Allahun dhe të dërguarin e Tij, tri herë."[13]

Kuptimi i përgjithshëm i hadithit

Shejtani nuk ndalet nga cytjet e tija drejtuar njeriut, duke e vënë atë në dyshime rreth imanit deri sa ta nxjerr atë në kufër, Allahu na ruajttë.

Gjëja e parë që shejtani i cyt njerëzit është rreth ekzistimit të Allahut, kështu që nis me një seri pyetjesh, që në fillim duken shumë të logjikshme. E pyet njeriun se kush krijoi qiellin e tokën? I pyeturi përgjigjet se Allahu është krijues i tyre. E shejtani e pyet herën e dytë; e kush e krijoi Allahun? Që është një pyetje naive, por që në vete përmban shumë ligësi, ana naive është në atë se pajtohet në çështjen se Allahu është Krijues, e më pas pyet se kush e krijoi Atë? Që janë dy gjëra të kundërta njëra prej tjetrës, për atë se pasi që Allahu është Krijues, nuk mundet që Ai të jetë edhe i krijuar, e nëse është i krijuar nuk mund të jetë krijues, pra një gjë nuk mund të cilësohet me të kundërtën e saj, sikur të thuhet për gurin; është i ngurtë i butë.

Qoftë edhe nëse i pyeturi përgjigjet se e ka krijuar një zot tjetër? Do parashtrohej pyetja e njejtë nga shejtani, se kush e krijoi atë zot tjetër? Kështu që përsëriten pyetjet e njejta, e përsëriten përgjigjet, e mbesim para dy mundësive; ose të shoqërojmë shejtanin në pyetjet e tija, e të mbesim duker përsëritur të njejtën përgjigje, të cilat nuk kanë fund, gjë

[13] Transmeton Ahmedi në "Musned-in" e tij (36/194) hadithi numër (21867).

www.albislam.com

e cila shpien në ateizëm të qartë; ose të ndërpresim cytjet që në fillim duke u mbështetur në besimin në Allahun, kështu na udhëzoi edhe vet i dërguari, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, i cili referoi që muslimani kur të dëgjon sofizmat e shejtanit të thotë: Besova në Allahun! E ta përsëritë atë tri herë, që t'ia bën me dije shejtanit se pyetja e tij shpien në mohim të Allahut, ndërsa ai beson në Të dhe e njeh ekzistimin e Tij; se pyetjet e shejtanit shpiejnë në anulimin e të gjitha provave logjikore, fetare, shqisore, e natyrshmërisë së pastër që aludojnë në ekzistimin e Allahut, të cilat shejtani nuk mund që me pyetjet e tija naive t'i mohon ato. Kështu që thënia e muslimanit : Besova në Allahun! Nuk është ikje nga pyetja e shejtanit, por, është një përgjigje shumë precize për atë që kupton thelbin e saj.

Dobi nga hadithi

1. Allahu është krijues i gjithçkaje.
2. Allahu është i Pari, Ai krijoi gjëra nga asgjëja.
3. Pyetjet e shejtanit janë të kota dhe jo korrekte.
4. Kujdesi i shejtanit për të përhapur mosbesimin, dhe thirrje në të.
5. Gjatë ballafaqimit me kësisoj pyetjesh muslimani thotë: Besoj në Allahun.
6. Kur muslimanit i vijnë cytje të tilla duhet të kërkon mbrojtjen e Allahut, siç përmendet në transmetimin tjetër të Muslimit "le të kërkon mborjtje nga Allahu".

www.albislam.com

FATI I VEPRAVE TË JOBESIMTARËVE PAS VDEKJES

HADITHI I TREMBËDHJETË

Aisheja, *Allahu qoftë i kënaqur prej saj*, përcjell e thotë: I thash të dërguarit të Allahut: Ibn Xhuda'n në kohën e injorancës mbante lidhjet farefisnore dhe ushqente të varfërit, a thua kjo i bën dobi atij? Ai u përgjigj: *Nuk i bën dobi; Ai asnjë ditë nuk tha: O Zot! Mi fal gabimet e mia ditën e Gjykimit*".[14]

Kuptimi i përgjithshëm i hadithit

Abdullah ibn Xhuda'n Temimi ishte një prej njerëzve në kohën e injorancës i njohur me bujari, i cili kishte një kazan, të cilin e kishte përgatitur për të ushqyer të varfërit. Për një njeri që gjendja e tij është e tillë njerëzit interesohen për të njohur hallin e tij pas vdekjes, posaçërisht nëse është nga të afërmit e tij! Në këtë rast Aisheja, *Allahu qoftë i kënaqur prej saj*, pyeti të dërguarin, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, për të, e për hallin e tij pas vdekjes, mes tyre kishte lidhje farefisnore, e i dërguari, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, iu përgjigj në mënyrë të qartë pa asnjë lloj hutie e paqartësie, se nuk i bën dobi vepra e tij, duke shpjeguar arsyen se ai asnjë herë nuk tha: O Zot, më mua fal gabimin tim, ditën e Kiametit. Pra, ai asnjëherë nuk besoi në ringjallje, e një person i cili e mohon ringjalljen ai është jobesimtar, e jobesimtarit Allahu nuk i pranon veprat, por, Allahu e begaton atë, dhe e shpërblen në këtë botë për veprat e mira që ka vepruar, duke i shtuar atij pasuri, fëmijë, apo t'ia zgjat jetën, apo t'i jep shëndet, apo edhe t'ia jep gjitha këto. "**Zoti yt, nuk i bën askujt padrejtësi**." Kehf, 49.

Dobi nga hadithi

1. Besimi është kusht i pranimit të veprave të mira, e përfitimit prej tyre në ahiret.
2. Allahu nuk e fal politeistin ditën e Kiametit.
3. Veprat e mira që i vepron një politeistit nuk i bëjnë dobi ditën e Kiametit.
4. Kush nuk beson në ringjallje ai është jobesimtar.

[14] Transmeton Muslimi (1/196) hadithi numër (214).

FUQIA ABSOLUTE E ALLAHUT

HADITHI I KATËRMBËDHJETË

Abdullah ibn Mesudi, *Allahu qoftë i kënaqur prej tij*, përcjell e thotë: një rabin erdhi tek i dërguari i Allahut, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, e i tha: O Muhamed! Allahu vendos qiellin në një gisht, dhe tokën në gishtin tjetër, malet në një gisht, e lumenjtë në një gisht tjetër, e gjithë krijesat tjera në një gisht tjetër. E më pas i thotë dorës së Tij: Unë jam Sundimtari. I dërguari i Allahut i buzëqeshi e tha: "(Hebrenjt) nuk e njohtën si duhet Allahun."[15]

Kuptimi i përgjithshëm i hadithit

Njeriut i duket shumë madhështore kur sheh fuqinë e shumë ndryshimeve natyrore si "erra e fortë", "tërmetet", "vullkanet", dhe krahason fuqinë e tyre kur flet për shkatërrimin masiv në tokë, në njerëz dhe në jetë në përgjithësi. Por, për shkak preukipimit të tepërt të tij me fuqitë e dukshme të natyrës harron fuqinë reale e cila lëviz çdo fuqi të tillë, ajo është fuqia e Allahut të Lartësuar i Cili posedon qeverisjen e gjërave në qiell e në tokë.

Përkujtimi i kësaj fuqie nuk është për t'i trishtuar njerëzit nga Zoti, por, për të mbjellur madhështinë e Tij në zemrat e tyre, madhështi e cila dhuron dashuri, e ndihmon në adhurim dhe falënderim të dhuntive.

I dërguari, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, pohoi fjalët e rabinit rreth fuqisë së Allahut, se si Ai me fuqinë e Tij i vendos qiejt e mëdha në gishtin e Tij, tërë tokën me gjithë gjerësinë dhe peshën e rëndë të saj e vendos në një gisht, malet e larta i vendos Allahu që të gjitha në një gisht, drunjët e lumenjtë e gjata, e gjithë krijesat tjera, të shumtë e të ndryshëm i vendos Allahu në një gisht.

[15] Transmeton Buhariu (9/134) hadithi me numër (7451). Dhe Muslimi (4/2147) hadithi numër (2786).

www.albislam.com

Cila fuqi mund të jetë më e madhe se fuqia e Allahut!

Çfarë fuqie është fuqia e Allahut!

Pas gjithë kësaj si mund që njerëzit të bëjnë mëkate, si mund që njeriu ta mohon, padyshim se butësia e Tij është shumë e madhe për robërit e Tij.

Dobi nga hadithi

1. Pohimi i fuqisë së Allahut, dhe madhështisë së Tij.
2. Obligueshmëria e madhërimit të Allahut.
3. Pohimi se Allahu posedon gishtërinjë, pa i ngjasuar ato dhe pa i shpjeguar menyrën e tyre.
4. Pohimi i dorës së Allahut, pa ngjasim dhe pa pyetur se si.
5. Pohimi i cilësisë së të folurit për Allahun.
6. Pranimi nga ithtarët e Librit lajmet e vërteta që ata i rrëfejnë.

www.albislam.com

ZHDUKJA E IMANIT KUR VIJE FUNDI I BOTËS

HADITHI I PESËMBËDHJETË

Enes ibn Maliku, *Allau qoftë i kënaqur me të*, përcjell se i dërguari i Allahut, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, ka thënë: "***Nuk do të ndodh Kiameti përderisa në tokë thuhet: Allah, Allah***."[16]

Kuptimi i përgjithshëm i hadithit

Ndodhinë e Kiametit është dituri të cilën Allahu e fshehu, nuk di askush se kur do të ndodh pos Ai që e krijoi atë. I dërguari i Allahut, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, njohtoi njerëzit për shenjat që aludojnë në afrimin e saj dhe ndodhinë e saj. Në këtë hadith i dërguari, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, flet me shokët e tij për kohën para Kiametit, përmend cilësitë e njerëzve të asaj kohe, saqë kanë arrit në grada të mosbesimit dhe ateizmit për aq sa në gjuhët e tyre nuk përmendet Allahu, si një shenjë e zhdukjes së çdo gjurme prej gjurmëve të imanit në zemrat e tyre, për shkak largimit të gjatë prej imanit, nënshtrimit ndaj dynjasë dhe mashtrimeve të saja.

Dobi nga hadithi

1. Kohën e ndodhisë së Kiametit e di vetëm Allahu.
2. Prej shenjave të afrimit të Kiametit përhapja e kufrit dhe zhdukja e imanit.
3. Kiameti do të ndodh mbi njerëzit më të këqij.

[16] Transmeton Muslimi (1/131) hadithi numër (148).

www.albislam.com

KURANI, FJALË E ALLAHUT

HADITHI I GJASHTËMBËDHJETË

Xhabir ibn Abdullahu, *Allahu qoftë i kënaqur e të*, përcjell e thotë: I dërguari i Allahut, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, dilte para njerëzve gjatë Haxhit e u thoshte: "***A ka ndonjë njeri që më dërgon tek farefisi i tij, ngase Kurejshitët më kanë ndaluar të kumtoj fjalët e Zotit tim***."[17]

Kuptimi i përgjithshëm i hadithit

I dërguari i Allahut, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, ishte shumë aktiv për ta përcjellur mesazhin hyjnor tek gjithë njerëzit, ndërsa Kurejshitët e pengonin atë, e i dërguari, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, shkonte tek fiset e ndryshme që vinin për haxh, e kërkonte prej tyre që të pranonin fenë, apo të garantonin sigurin e tij që ai të kumton fjalën e Allahut tek njerëzit.

Dobi nga hadithi

1. Pohimi i cilësisë së të folurit për Allahun, dhe se Allahu flet kur dëshiron dhe si Ai dëshiron.
2. Pohimi se Kurani është fjalë e Allahut.
3. Se i dërguari, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, është i dërguar nga Allahu.

[17] Transmeton Ebu Davudi (4/234) hadithi numër (4734). Dhe Tirmidhiu (5/184) hadithi numër (2925).

www.albislam.com

ÇDO GJË FUNKSIONON ME LEJEN DHE DËSHIRËN E ALLAHUT

HADITHI I SHTATËMBËDHJETË

Zejd ibn Halid Xhuheniu, *Allahu qoftë i kënaqur prej tij*, përcjell dhe thotë: Na e fali i dërguari i Allahut, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, namazin e sabahut në Hudejbije, pas një nate plot me shi, pasi që përfundoi namazin u kthye kah njerëzit dhe tha: "A e dini se çfarë thotë Zoti juaj? Thanë: Allahu dhe i dërguari i Tij e dinë më mirë. Tha: Allahu thotë: "Prej robërve të Mi disa janë zgjuar si besimtarë e disa si jobesimtarë, cilido që tha se ra shiu (si shenjë) e mirësisë dhe mëshirës së Allahut, ai është besimtar në Mua dhe mohues i yjeve; e kush thotë se shiu ra nga ky e ky yll, ai më ka mohuar Mua dhe ka besuar yjet."[18]

Kuptimi i përgjithshëm i hadithit

I dërguari, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, shfrytëzoi çdo rast që të mbjell në zemra kuptime imanore, e vlera të besimit, të përmirëson çdo pasqyrim të gabuar, e të jep vërejtje për çdo fjali që mund të përmban kuptim të gabuar apo të aludon në besim të kotë.

Në këtë hadith, i dërguari, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, shëron disa trashëgimi të injorancës prej besimeve të kota të cilat ishin tek ta, sikur thënia se; shiu zbret për shkak zbritjes e zhdukjes së yllit.

Ndoshta muslimanët e kanë thënë këtë fjalë të injorancës pa pasur për qëllim kuptimin e saj, e i dërguari i Allahut, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, ua tërhoqi vërejtjen për rrezikun e këtyre fjalëve që bartin kuptime të gabuara, e u sqaroi atyre se Allahu është Krijuesi, Furnizuesi, dhe Ai është i Cili zbret shiun, si pasojë e mirësisë dhe mëshirës së Tij, dhe se çfarë flitet në gjuhët e njerëzve duke përcaktuar shkakun e zbritjes

[18] Transmeton Buhariu (1/169) hadithi me numër (846). Dhe Muslimi (1/83) hadithi numër (71).

www.albislam.com

së shiut tek yjet gjatë rënies apo paraqitjes së tyre, është thënie jo e saktë, ngase yjet e planetët nuk kanë të bjënë me të, por është mirësi dhe mëshirë nga Allahu, begaton me të kë Ai do prej robërve të Tij.

Dobi nga hadithi

1. Ndalimi i referimit të shiut tek yjet e planetet.
2. Kush pretendon se shkaqet normale janë vetëvepruese është jobesimtar.
3. Gjithçka lëviz me lejen dhe dëshirën e Allahut.
4. Kufri arrihet edhe me fjalë të kufrit, sikurse me bindje të kufrit.
5. Obligueshmëria e atribuimit të mirësisë Allahut të Madhëruar.
6. Allahu cilësohet me mirësi dhe mëshirë.
7. Prej cilësive të Allahut është të folurit.

www.albislam.com

POHIMI SE ALLAHU FLET

HADITHI I TETËMBËDHJETË

Adij ibn Hatim, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, përcjell se i dërguari i Allahut, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, ka thënë: "***Secilit prej jush do i flet Allahu, mes tyre nuk do të ketë përkthyes, e as pengesë që e fsheh***."[19]

Kuptimi i përgjithshëm i hadithit

I dërguari, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, kishte një kujdes të jashtëzakonshëm për të sqaruar gjendjen e besimtarëve në botën tjetër, gjendjen e lumturisë dhe kënaqësisë, asnjëherë nuk ndalonte të sillte disa skena nga ajo kënaqësi dhe sferat e saj. Në këtë hadith i dërguari, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, përmendi një prej kënaqësive më të mëdha me të cilat Allahu e begaton besimtarin ditën e Kiametit, e që është të folurit me Allahun e Madhëruar, e dëgjimin e zërit të Tij pa ndonjë ndërmjetësues, vërtet, është një dhunti e madhe për atë që mediton rreth saj. Njeriu ndihet i qetë gjatë bisedës me një dashamir të tij, si dhe të folurit me një mbret prej mbretërve të kësaj bote për të është një gjë madhështore, e si është kur ai do të flet me Mbretin e mbretërve dhe Krijuesin e tyre, vërtetë është një dhunti për të cilën do t'i kushton vëmendje që ta arrijë ai i cili e kupton vlerën e saj , e të vepron çdo gjë që e bën të jetë meritor i bisedës me Zotin e Madhëruar.

Që këtu, erdhi përgëzimi profetik për të folurit të Allahut me robërit e Tij besimtarë, që t'i nxit ata që ta arrijnë këtë nderim fisnik, pozitë të lartë, e të veprojnë vepra të mira që i bëjnë krenarë për takimin me Allahun, të pa turpëruar për punët e mëkatet e vepruara.

Dobi nga hadithi

1. Pohimi i të folurit të Allahut e Madhëruar me robërit e Tij.
2. Nderimi i besimtarëve me të folurit me Zotin e botëve.
3. Besimtarët do të shikojnë në Zotin ditën e Kiametit.
4. Dëgjimi i fjalës së Allahut, dhe kuptimin e atyre fjalëve pa ndërmjetësues.

[19] Transmeton Buhariu (9/132) hadithi me numër (7443). Dhe Muslimi (2/703) hadithi numër (1016).

www.albislam.com

ATRIBUTET E ALLAHUT NË SUREN IHLAS

HADITHI I NËNTËMBËDHJETË

Aisheja, *Allahu qoftë i kënaqur prej saj*, tregon se i dërguari, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, dërgoi një njeri së bashku me një ekip vëzhgues, i cili çdo herë në namazin me shokët e tij falej dhe e përfundonte (leximin) namazin me "Thuaj! Allahu është Një." (Sureja Ihlas, 1). Kur ata u kthyen ia përmendën këtë të dërguarit, -paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të-, e ai tha: "Pyeteni, për çfarë arsye ai vepron ashtu? Ata e pyetën, dhe ai iu përgjigj atyre: se kjo sure flet për atributet e të Gjithëmëshirshmit, dhe dua që ta lexoj. E i dërguari, -paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të-, u tha: Tregoni atij se Allahu e do atë."[20]

Kuptimi i përgjithshëm i hadithit

Shokët e të dërguarit, alejhi selam, kishin dalur për një vëzhgim, për të cilin i kishte urdhëruar i dërguari, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, dhe kishte caktuar për ta një njeri nga më të mirët që të jetë ai prijësi i tyre. Kështu që, ky njeri ua falte atyre namazin dhe e përfundonte leximin në namaz me suren "Ihlas", për çfarë sahabët u habitën nga kjo vepër e tij.

Pasi që u kthyen në Medine e pyetën të dërguarin, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, për veprimin e tij, e ai, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, u tha që të interesohen për shkakun pse ai ka lexuar të njejtën sure çdo herë që është falur me ta. Dhe u kishte treguar se ai e do shumë këtë sure, për arsye se përmban vetëm atributet e Allahut të Mëshirshmit, e kur i dërguari, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, kuptoi këtë prej tij u tha që ta përgëzojnë se Allahu e do atë.

[20] Transmeton Buhariu (9/115) hadithi me numër (7375). Dhe Muslimi (1/557) hadithi numër (813).

www.albislam.com

Dobi nga hadithi

1. Pohimi i njëshmërisë së Allahut, mbështetur në fjalën e Allahut: "Thuaj! Ai Allahu është Një."
2. Pohimi i emrit "El Ehad" i Vetmi, Një, është një prej emrave të Allahut, që nënkupton se Ai është i Vetëm në Qenie, në vepra, në emra dhe atribute.
3. Pohimi i emrit "Es Samed" I Përjetshmi, i Përhershëm, Përmbushës i çdo nevoje të krijesave të Tija.
4. Mohimi i të pasurit fëmijë Allahu i Madhëruar.
5. Mos veprimi i çdo lloji të shikrut ndaj Allahut të Madhëruar, nga vendosja e dikujt në pozitë të njejtë me Të, se Allahu nuk ka të ngjashëm, të njejtë, nuk ka si Ai në Qenie, e as në veprimet e Tija, e as në emra dhe atribute.
6. Pohimi se Allahu është i Pari, ai është i Pari dhe para Tij ska gjë, dhe se Ai nuk është i krijuar por Ai është Krijues i çdo gjëje.
7. Pohimi i cilësisë së dashurisë për Allahun e Madhëruar, se Allahu i do besimtarët, të devotshmit e të mirët.

www.albislam.com

ÇELËSAT E GAJBIT

HADITHI I NJËZETË

Ibn Omeri, *Allahu qoftë i kënaqur prej tij*, përcjell se i dërguari, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, ka thënë: "Çelësat e gajbit (fshehtësive) janë pesë, askush nuk i di ata përveç Allahut: Askush nuk e di se çfarë bartin gratë shtatzëna, pos Allahut, askush nuk di se çfarë do të ndodh nesër, pos Allahut, askush nuk di se kur do të bie shi, pos Allahut, nuk di njeriu se në ç'vend do të vdes, pos Allahut, dhe askush nuk e di se kur do të ndodh Kiameti, pos Allahut."[21]

Në një trasnmetim tjetër se i dërguari, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, ka thënë: Çelësat e gajbit janë pesë, e më pas lexoi ajetin: "Me të vërtetë, vetëm Allahu e di Çastin (Ditën e Kijametit), Ai e zbret shiun dhe di çka ka në barkun e shtatzënës, e askush nuk di ç'do të fitojë nesër dhe askush nuk di se në ç'vend do të vdes. Me të vërtetë, Allahu është i Gjithëdijshëm dhe njohës i çdo gjëje." Llukman, 34[22]

Kuptimi i fjalëve

Çelësa: është njëjës i emrit çelës, që përdoret për të hapur diç, në këtë kontekst është përdorur emri çelës për gjërat e fshehta (gajb) sa për të ilustruar, për shkak se çështjet që janë gajb ngjasojnë me gjërat të cilat fshehen nga njerëzit, siç janë pasuritë e çmuara të cilat futen në depo të siguruara, të mbyllura me dry, në mënyrë që të mos e di askush se çfarë ka brenda, pos atij që posedon këto çelësa.

Gajb: është një gjë i mbuluar, i fshehtë, sekret për njerëzit, e jo për Allahun e Madhëruar, ngase nga Ai nuk fshehet asgjë.

[21] Transmeton Buhariu (9/116) hadithi me numër (7379).
[22] Transmeton Buhariu (6/115) hadithi me numër (4778).

www.albislam.com

Kuptimi i përgjithshëm i hadthit

Ky hadith flet për një gjë shumë me rëndësi, e që është përkufizimi i gajbit vetëm në Allahun e Madhëruar, ashtu që askush pos Allahut nuk e di të fshehtën.

Ky hadith tregon disa lloje të fshehtësive të cilat i di vetëm Allahu, të cilat janë veçuar në këtë hadith për arsye se lidhen ngushtë me jetën, fatin dhe furnizimin e njeriut.

Përmendi veçimin e dijes mbi ndodhinë e Kiametit, e cila ka të bëjë me fillimin e jetës së njeriut në botën tjetër, në ajet u përmend ajo e para për shkak rëndësisë që ka. Përmendi veçimin e dijes mbi rënien e shiut, që është një prej shkaqeve me anë të së cilës furnizohet njeriu dhe gjallërohet toka. Përmendi të veçuarit e Allahut me dije për foshnjët në barqet e nënave, dijen mbi gjininë dhe fatin e tyre. Përmendi të veçuarit e Allahut në dije për të nesërmen e njeriut, e të veçuarit për vendin se ku do të vdes ai.

Këta janë pesë çelësat e gajbit që kanë të bëjnë me jetën e njeriut që prej kur është foshnje, në vdekje e deri në ringjallje.

Dobi nga hadithit

1. Askush pos Allahut nuk di të fshehtën.
2. Çdo pretendim i njohjes së të fshehtës është e pavërtetë (e kotë), qoftë përmes astrologjisë, fallxhorëve, etj.
3. Nga ajeti dhe hadithi nuk kuptohet përkufizimi i çështjeve të gajbit vetëm në këto pesë, por këto janë veçuar ndër të tjerat për nga lidhja e tyre me çështjet e njeriut, që prej kur të jetë embrion e momentin e vendin e vdekjes, e deri në ditën e Kiametit, që nuk e di askush se kur do të ndodhë, qoftë edhe nëse është afër saj për sa dy harqe apo edhe më afër. Pra, ajeti qorton njeriun i cili pyet për kohën se kur do të ndodh Kiameti, i thuhet atij: O ti njeri! Po pyet për kohën se kur do të jetë Kiameti, e ti nuk e di jetën tënde, e as që di se çfarë do të përjetosh të nesërmen, edhe pse është vepër e jotja dhe koha që ti po e jeton, ti as nuk e di se ku do të vdesësh, edhe pse ky është preokupimi jot, e si të njohësh Kiametin se kur do të jetë?! E nevojshme është të dihet se ai do të ndodh, dhe e nevojshme është të veprohet për atë ditë.
4. Gajbi është dy llojësh: Gajb i tërësishëm të cilin nuk e di askush pos Allahut, si këto pesë të përmendurat në ajet dhe në hadith; dhe gajb i pjesërishëm i cili për disa

www.albislam.com

njerëz është i panjohur e për disa të tjerë i njohur, atë që një person e sheh në një vend është e panjohur për një tjetër që nuk është në atë vend.

5. Kohën se kur do të ndodh Kiameti e di vetëm Allahu, e askush nuk di se kur do të ndodh. Kur Xhibrili, alejhi selam, pyeti të dërguarin, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, për Kiametin, ai u përgjigj: "As i pyeturi nuk di më tepër se sa pyetësi." Shënon Buhariu. Pra, unë dhe ti jemi të njejtë për mosnjohjen e kohës së ndodhisë.
6. Zbritjen e shiut e di vetëm Allahu, dhe se atë që tregojnë metereologët është një paramendim i ndodhisë, e jo edhe vendosmërisht se ajo do të ndodh. Për atë i cili përcjell lajmet që flasin për paramendimet e rënies së shiut duke ia bashkangjitur atij lajmërimi fjalën "me lejen dhe dëshirën e Allahut", sikur të thotë: Pritet të bie shi, ditën e nesërme, me lejen e Allahut.
7. Allahu ka veçuar për Vete dijen për foshnjet në barqet e nënave, se a është mashkull apo femër, dhe atë në secilën etapë të foshnjës që duke qenë pikë uji, e gjak i ngjizur, e një copë mishi, e derisa të formohet në trup të kompletuar, Ai njeh edhe fatin e foshnjes se a do të jetë i mirë apo i keq, se a do të jetë i bukur apo i shëmtuar. Ajeti dhe hadithi nuk bie ndesh me atë që sot ka arritur shkenca bashkëkohore, për mundësinë e njohjes së llojit të foshnjës, pasi që kjo njohje është në etapat e mëvonshme që nga formimi i embrionit, e jo edhe në fillim të krijimit.
8. Askush nuk di se çfarë do të përfitojë ditën e nesërme, apo të njeh për dikë tjetër për të ardhmen, qoftë në dije, vepra apo në pasuri.
9. Askush nuk e di vendin e as kohën se ku do të vdes, e as për dikë tjetër. Këtë njohuri e fshehu Allahu në dijen e Tij.
10. Ai i cili pretendon se e di të fshetën bëhet jobesimtar dhe atë për arsye se dijen të cilën e fshehu Allahu nga krijesat e Tija ai e përvetëson, dhe për arsye se ka përgënjeshtruar Kuranin i cili ka përkufizuar gajbin në Allahun e Madhëruar, Allahu thotë: "**Thuaj: "Askush, pos Allahut, as në qiell as në Tokë nuk di sekretet, ata nuk dinë se kur do të ringjallen**." Neml, 65.
11. Pohimi i cilësisë së dijes për Allahun.

www.albislam.com

PËRJETSHMËRIA E BANORËVE TË XHENETIT DHE BANORËVE TË ZJARRIT

HADITHI I NJËZET E NJË

Ebu Said el Hudriu, *Allahu qoftë i kënaqur prej tij*, përcjell se i dërguari i Allahut, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, ka thënë: "(ditën e Kiametit) Sillet vdekja në formë të një dashi të majmë dhe thërret një thirrës: O banorë të Xhenetit! Ata ngrisin kokat dhe shikojnë. U thuhet: A po e njihni këtë? Thonë: Po, kjo është vdekja. E që të gjithë e shohin. Pastaj thërret: O banorë të zjarrit! Ata ngrisin kokat dhe shikojnë. U thuhet: A po e njihni këtë? Po, është vdekja, përgjigjen ata. E që të gjithë e shohin. Urdhërohet të theret, e u thuhet: O banorë të Xhenetit! Përjetshmëri, më nuk ka vdekje! O banorë të zjarrit! Përjetshmëri, më nuk ka vdekje! Pastaj i dërguari, alejhi salatu ve selam, lexoi nga Kur'ani: "Ti tërhiqju atyre vërejtjen për ditën e dëshpërimit, kur të marrë fund çështja (e përgjegjësisë e dikush në xhennet, dikush në zjarr), se ata (sot) janë të shkujdesur, dhe ata nuk janë duke besuar".[23]

Kuptimi i përgjithshëm i hadithit

Zhdukja dhe kënaqësia janë dy gjëra të kundërta, dhe e para ndikon në përsosmërinë e të dytës, pra, për aq sa njeriu i begatuar me të mira supozon se mirësitë kurdoherë do të përfundojnë, kjo gjë i shktakton atij dhimbje, e krijohet një lloj dëshpërimi për mirësitë që ka. Po njejtë njeriu i munduar kur të mendon se do të vije një ditë kur do të përfundon vuajtja e tij, ai mundim do t'i lehtësohet, e durimi i shtohet, shpresat e tija ia lehtësojnë lodhjet e gjendjen që e ka.

Shtimin e kënaqësisë së besimtarëve dhe dënimit për jobesimtarët Allahu e vulos me therjen e vdekjes, therje reale të cilën do e dëshmojnë që të gjithë prej banorëve të xhenetit dhe banorëve të zjarrit, dhe atë për të refuzuar çdo mëdyshje të shpresave të jobesimtarëve për shpëtim, e të ndërpret çdo dilemë të zhdukjes e humbjes së kënaqësisë

[23] Transmeton Buhariu (6/93) hadithi me numër (4730). Dhe Muslimi (4/2188) hadithi numër (2849).

www.albislam.com

së përhershme, gjë e cila i dëshpëron banorët e xhenetit. Për këtë gëzohen shumë banorët e xhenetit, e dëshpërohen banorët e zjarrit, për ta s'ka shpëtim, do të dënohen fizikisht, ngase gjenden në vendin e dënimit dhe do të dënohen psiqikisht duke ndërprerë çdo shpresë për shpëtim.

Dobi nga hadithi

1. Xheneti dhe xhehenemi janë të përhershëm.
2. Besimtarët do të qëndrojnë në xhenet përgjithmonë, e jobesimtarët në zjarr.
3. Therja e vdekjes nënkupton përhershmëri të qëndrimit në ahiret.
4. Emërtimi i ditës së Kiametit ditë e Dëshpërimit, për shkak të dëshpërimit të jobesimtarëve për mospërfilljen e udhëzimeve të Allahut.

www.albislam.com

BESIMI I SINQERTË

HADITHI I NJËZET E DY

Ebu Hurejra, *Allahu qoftë i kënaqur prej tij*, tregon e thotë: erdhën disa njerëz tek i dërguari, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, dhe e pyetën: Ne në vetët tona hasim gjëra, që po të fliste ndokush prej nesh për to, do të konsiderohej si një fjalë (gabim) shumë e madhe: ai tha: "A keni hasur në këtë! Thanë: Po! Tha: Ky është Imani i sinqertë".[24]

Kuptimi i përgjithshëm i hadithit

Cytjet janë arma e shejtanit me të cilat i devijon njerëzit, disa e konsiderojnë si të thjeshtë këtë armë të tij, por që ndikimi i tij tejkalon atë që mund të shkaktojnë armët e vërteta, sidomos kur një cytje del nga një që është i dijshëm për gjendjen e njerëzve, i njeh pikat e dobëta të tyre, dhe çfarë i shtynë ata në mëdyshje.

Prej gjërave më të rrezikshme që shejtani mund të shkakton cytje në to janë çështjet e besimit, e prej çështjeve më të rrezikshme është çështja e ekzistimit të Allahut, që një besimtar e konsideron një gabim gjigant nëse bën kufër në të, frika e madhe e tij shihet në atë se vetëm kalimi i atyre rreziqeve të shejtanit në veten e tij është një lloj i mëkatit për të.

Kjo që ngjau me sahabët e nderuar –*Allahu qoftë i kënaqur me gjithë ata*- gjatë cytjeve të shejtanit, janë të këtij lloji të çështjeve, pasi që të folurit me ato gjëra e konsideronin si gjë shumë të madhe, e kishin frikë se ajo që sillej në mendimet e tyre të konsiderohej mëkat, e të binin në gjendje të vështirë, kështu që shpejtuan ta pyesin të dërguarin, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, i cili i qetësoi dhe u sqaroi se frika dhe shqetësimi i tyre për këto cytje është një argument i qartë për imanin e saktë, përndryshe po të mos ishin besimtarë, apo besimi i tyre të ishte në dyshime, do i ndjeknin ato cytje, e as që do të pyetnin të dërguarin, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*- që t'i përgjigjet

[24] Transmeton Muslimi (1/119) hadithi numër (132).

www.albislam.com

atyre pyetjeve, por, refuzimi i atyre cytjeve dhe ikja nga mëkati ishte një argument i vërtetë për imanin e pastër të tyre.

Dobi nga hadithi

1. Rreziku i shejtanit qëndron në cytjet e tija.
2. Ikja e besimtarit nga cytjet e shejtanit.
3. Besimtari i sinqertë nuk ndikohet e nuk i kushton rëndësi cytjeve të shejtanit.
4. Besimtari nuk mirret në pyetje për cytjet e shejtanit që i vijnë.
5. Kthimi tek dijetarët në rast kur diç mund ta turbullojë imanin e pastër.

www.albislam.com

MIQËSIMI ME BESIMTARËT

HADITHI I NJËZET E TRE

Amr ibn Asi, *Allahu qoftë i kënaqur prej tij*, përcjell e thotë: Kam dërgjuar të dërguarin e Allahut , -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, duke thënë: "Familjarët e Ebu filanit, nuk janë dashamirët e mi. Padyshim që Miku im është Allahu dhe besimtarët e drejtë e të vërtetë, por me atë familje kemi farefisni, kështu që i mbaj ato lidhje ashtu siç duhet të mbahen".[25]

Kuptimi i përgjithshëm i hadithit

Islami ka ndarë shoqërinë dy llojësh: besimtarë dhe jobesimtarë. Kështu që besimtarët janë të obliguar të miqësohen me njëri-tjetrin, të duhen, të ndihmohen e të solidarizohen me njëri-tjetrin, ashtu siç obligohen të mos miqësohen me jobesimtarët, gjë e cila nënkupton urrejtjen e kufrit dhe mëkateve që ata i veprojnë, mosqëndrimi me ta në ballafaqim kundër muslimanëve, duke u dëtyruar që të sillen me ta me drejtësi. Kush prej tyre (jobesimtarëve) është i afërt me një musliman, islami nuk e ka detyruar muslimanin që të shkëput lidhjet me të e ta braktis atë, por islami e urdhëron që të sillet mirë e të jetë bamirës ndaj tij.

Ky hadith sqaron për mënyrën e praktikimit të kësaj metodologjie, largohet nga miqësimi me jobesimtarët, duke i përmendur ata me emra, e tregon se miqësimi i tij është me Allahun, dhe me besimtarët e drejtë. Megjithatë, ai besatohet që t'i mbajë lidhjet familjare me ta, kjo është një metodologji që duhet çdo musliman ta ndjekë, e të miqësohet me besimtarët dhe të largohet nga jobesimtarët, pa u shkaktuar atyre padrejtësi, apo të ndërpret lidhjet farefisnore me ta, kështu ai mund të mban fenë dhe besimin e tij të shëndoshë.

[25] Transmeton Buhariu (6/8) hadithi me numër (5990). Dhe Muslimi (1/197) hadithi numër (215).

www.albislam.com

Dobi nga hadithi

1. Besimtarët obligohen të jenë dashamirë të Allahut, me iman dhe pasim të urdhërave të Tij
2. Besimtarët obligohen të jenë dashamirë të të dërguarit, duke besuar në të dhe duke qenë pasues të traditës së tij.
3. Besimtarët obligohen të jenë dashamirë me vëllezërit e tyre besimtarë, t'i duan e t'i ndihmojnë.
4. Besimtarit mëkatar i takon miqësimi për aq sa është imani dhe adhurimi i tij, duke urryer mëkatet e tija.
5. Lidhja imanore është më e fortë sesa lidhja farefisnore.
6. Besimtarët detyrohet të largohen nga miqësimi i jobesimtarëve, duke urryer kufrin në të cilin ata gjenden, në të njëjtën kohë obligohet të sillen me ta me drejtësi.
7. Largimi nga miqësimi i jobesimtarëve nuk nënkupton shkëputjen e lidhjeve farefisnore, e ndërprerjen e bamirësisë ndaj tyre.

www.albislam.com

NDËRMJETËSIMI DHE DALJA E BESIMTARËVE NGA ZJARRI

HADITHI I NJËZET E KATËR

Ebu Said, *Allahu qoftë i kënaqur prej tij*, përcjell se i dërguari i Allahut, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, ka thënë: "Sa u përket banorëve të zjarrit të cilët qëndrojnë aty, ata as që do të vdesin e as që do të shpëtojnë, por, disa njerëz që i ka kapluar dënimi i zjarrit si pasojë e mëkateve (apo gabimeve) të tyre, dënohen deri sa të humbin ndjenjat e të bëhen si qymyri, do lejohet për ta shefati, e sillen grupe grupe, ndahen nëpër lumenjtë e xhenetit, e më pas u thuhet (banorëve të xhenetit): O banorë të xhenetit, hudhni mbi ta ujë, kështu që ata riformohen njëjtë sikur që zhvillohet fara e mbjellur në një skaj të lumit."[26]

Kuptimi i përgjithshëm i hadithit

Mëshira e Allahut është e madhe, mirësia e Tij është e pakufishme, mirësitë dhe mëshira e Tij janë më të mëdha dhe më të gjëra ndaj krijesave në ahiret, shumëfishi i asaj që është në këtë botë, e prej llojeve të kësaj mëshire lejimi i Allahut për pejgamberët dhe njerëzit e mirë prej robërve të Tij, që të ndërmjetësojnë për disa njerëz që veprat e tyre ishin të mangëta që të hyjnë në xhenet, e mëkatet e tyre ishin tej mase të mëdha, kështu që hyrën në zjarr. E Allahu i begaton ata me lejen e Tij për ndërmjetësim, e nxirren prej zjarri pasi të jenë djegur në të , saqë të jenë bërë si qymyr, do hudhen në lumenjë afër xhenetit, e do urdhërohen banorët e xhenetit që të hudhin ujë mbi ta, kështu që u rikthehet atyre gjallëria, riten e zhvillohen ashtu si një farë ritet afër një lumi, dalin të gëzuar, të sihariquar, falënderues ndaj Allahut për dhuntitë e begatitë e Tija.

Dobi nga hadithi

1. Se banorë të zjarrit janë jobesimtarët.
2. Përjetshmëria e jobesimtarëve në zjarr, është përhershmëri, nuk do të vdesin.
3. Disa nga besimtarët gjynahqarë do të hyjnë në zjarr si shkak i gjynaheve të tyre.
4. Pohimi i ndërmjetësimit për besimtarët gjynahqarë, që të dalin nga zjarri.
5. Ndërmjetësimi nuk i takon askujt përveç kujt Allahu i lejon.

[26] Transmeton Muslimi (1/172) hadithi numër (185).

www.albislam.com

VLERA E SHOKËVE TË PROFETIT
ALLAHU QOFTË I KËNAQUR PREJ TYRE

HADITHI I NJËZET E PESTË

Abdullah ibn Mesudi, *Allahu qoftë i kënaqur prej tij*, përcjell se i dërguari i Allahut, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, ka thënë: "Gjenerata më e mirë është gjenerata ime, pastaj ata që vijnë më pas, pastaj ata që vijnë më pas, pastaj do të vijnë disa popuj dëshmia e tyre do i paraprijë betimit, e betimi do i paraprijë dëshmisë".[27]

Kuptimi i përgjithshëm i hadithit

Sahabij është ai i cili e ka parë të dërguarin, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, ka besuar në të dhe nuk është kthyer në mosbesim deri në vdekje.

Ata janë prijësat e njerëzimit, njerëzit më të mirë pas profetëve. Ata janë të cilët ndihmuan fenë e Allahut dhe të dërguarin e Tij, përhapën fenë, na e përcollën neve Kuranin dhe sunetin, për këtë, të nderohen është obligim, të duhen është obligim.

I dërguari, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, në këtë hadith na tregon për vlerën e tyre mbi gjithë umetin, që ne të kryejmë detyrën tonë karshi tyre, të mësojmë vlerat që u përkasin.

Më pas i dërguari, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, përmend tabiinët, ata janë të cilët kanë takuar sahabët dhe kanë ecur në rrugën e tyre, këta janë në gradën e dytë në vlerë pas sahabëve, pas tyre në vlerë vijnë tabi-tabiinët, këta janë të cilët kanë takuar tabiinët dhe nuk kanë takuar asnjë prej sahabëve, të cilët ecën rrugës së tyre, këta janë në vlerë pas tabiinëve.

Ky vlerësim është kolektiv, pra, tabiinët në përgjithësi janë më të mirë se ata që erdhën më pas, ndërsa sa i takon individëve, mund që një individ i umetit të jetë më i mirë

[27] Transmeton Buhariu (3/171) hadithi me numër (2652). Dhe Muslimi (4/1963) hadithi numër (2533).

www.albislam.com

se disa individë nga tabiinët apo tabi-tabiinët. Vlerësimi në hadith është për pasimin dhe ndjekjen e tyre në punë të mira, e jo thjesht vetëm prezenca e jetesa në një kohë të caktuar, kjo gjë nuk i jep përfitim njeriut.

Dobi nga hadithi

1. Vlera e sahabëve mbi ata që vijnë më pas.
2. Sahabët janë njerëzit më të mirë pas profetëve, alejhim selam.
3. Ndalohet sharja apo fyerja e sahabëve.
4. Vlera e tabiinëve të cilët ecën në metodologjinë e sahabëve.
5. Vlera e tabi-tabiinëve, prej tyre që takuan tabiinët dhe ndjekën rrugën e tyre në pasimin e sahabëve.
6. Vlera e tre gjeneratave të para mbi tjerat që erdhën më pas.
7. Gjeneratë e keqe bëhet si shkak i moralit që shfaqet te ajo gjeneratë, prej sjelljeve të këqija.

www.albislam.com

KU ËSHTË ALLAHU?

HADITHI I NJËZET E GJASHTË

Muavije ibn el Hakem es Sulemij, *Allahu qoftë i kënaqur prej tij*, rrëfen; se një ditë erdhi tek i dërguari, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, për ta pyetur për një robëreshë të tijën, të cilën ai e kishte goditur, e i dërguari, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, i tregoi se kishte bërë një gabim shumë të madh, e ai i tha: O i dërguar i Allahut, a ta liroj? I tha: Ma sjell këtu? Pasi që erdhi i dërguari, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, e pyeti: "Ku është Allahu?" Ajo tha: Mbi qiell! E pyeti: Po kush jam unë? Ajo u përgjigj: Ti je i dërguari i Allahut! I dërguari, -paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të-, i tha: "Liroe, se është besimtare!"[28]

Kuptimi i përgjithshëm i hadithit

Ky hadith na shpalos kuptime të mëdha të mëshirës, që është mëshira e muslimanit për atë që ka ndër te, si robërit, në çrast islami ka obliguar që të trajtohen me sjellje te mirë dhe me nderë, duke ndaluar që të sulmohen, e të angazhohen me lloj pune që ata s'mund ta bartin. Sqaroi se nëse sulmohen ata me goditje, apo poshtërim, atëherë shpagim më i mirë për këtë veprim është të lirohen nga robëria.

Për këtë i dërguari, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, urdhëroi Muavije ibn el Hakem, *Allahu qoftë i kënaqur prej tij*, që ta liron robëreshën pasi që e kishte goditur, por, njëkohësisht dëshiroi të teston besimin e saj në Zotin e Madhërishëm, se sa ajo e njeh Atë, kështu që e pyeti se: Ku është Allahu? E Ajo u përgjigj se Allahu është mbi qiell, pra qëndron mbi qiej. E pyeti më pas për veten, e iu përgjigj se ai është i dërguari i Allahut. E i dërguari, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, urdhëroi Muavijen që ta liron, dhe dëshmoi për imanin e saj pas përgjigjes së dy pyetjeve.

[28] Transmeton Muslimi (1/381) hadithi numër (537).

www.albislam.com

Dobi nga hadithi

1. Lejohet që përgjegjësi i muslimanëve t'i teston njerëzit në çështje të besimit kur është nevoja.
2. Lejohet të dëshmohet për imanin e ndokujt sipas perceptmit të jashtëm.
3. Pohimi i qëndrimit lart për Allahun e Madhëruar.
4. Pohimi i profetësisë për Muhamedin, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-.

DEXHALLI

HADITHI I NJËZET E SHTATË

Hudhejfe Ibn Jemani, *Allahu qoftë i kënaqur prej tij*, përcjell se i dërguari i Allahut, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, ka thënë: "Unë e di më së miri për atë se çfarë posedon Dexhalli me vete, ai do të ketë dy lumenj; atë që e sheh syri ujë i bardhë, e tjetri sipas asaj që sheh syri, zjarr flakërrues. Kushdo që e takon, le të zgjedh lumin që sheh se është zjarr, le t'i mbyll sytë, le të ulë kokën e të pijë prej tij, në fakt ai është ujë i ftohët. Dexhalli do të jetë me një sy të shuar, mbi të do të ketë një lëkurë të trashë, mbi sytë e tij do të shkruan "Kafir", e lexon atë çdo besimtar, di shkrimlexim apo nuk di."[29]

Kuptimi i përgjithshëm i hadithit

Emri Dexhall ka kuptimin; gënjeshtar, është emër i një personi i cili do të del pak para ditës së Kiametit, i cili do të pretendon se është zot, dhe Allahu do t'ia mundëson që me duart e tija të bën çudira e gjëra të jashtëzakonshme me çfarë do të shtohet sprova për njerëzit, dalja e tij do të shkakton dridhje dhe dilema në besim, e do të ndahen njerëzit rreth tij, mes atij që do të jetë besnik i bindur, pasues, me vetëdëshirë apo nga frika, dhe ai që do e përgënjeshtron dhe do të ikë nga fitneja e tij.

Për arsye se sprova e tij është aq e madhe, të gjithë profetët tërhoqën vërejtjen prej tij, edhe i dërguari, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, tërhoqi vërejtje prej tij herë pas here, që të jetë sa më e qartë për Umetin, sqaroi detajet rreth tij, përshkroi fizionominë dhe trupin e tij, përmendi mashtrimet dhe mënyrat e gënjeshtrave të tija, përmendi se kush do të jenë pasuesit dhe dashamirët e tij, se sa do të qëndron në tokë, se si do të vdes, kush do e vret, me detaje precize, që përfshijnë gjithë jetën e Dexhallit, si këshillë për Umetin, për të mbrojtur fenë e tyre, e të mos futet në të dilema e mëdyshje.

[29] Transmeton Muslimi (4/2249) hadithi numër (2934).

www.albislam.com

I dërguari, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, njashtu sqaroi në këtë hadith, disa cilësi të tij, sqaroi se ai me vete do të ketë dy lumenjë, njëri është i bardhë, siç u duket njerëzve, e tjetri zjarr, ashtu siç u duket njerëzve, e i dërguari, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, porositi që kush e arrin këtë ditë, le t'i mbyll sytë e tij, e le të hyjë në lumin që sheh në të zjarr, sepse në realitet ai lum është me ujë të freskët, njashtu i dërguari, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, tregoi se njërin sy e ka të verbër, rreth e përqark ka qime, që të jetë më e qartë për besimtarët, kështu që Allahu e turpëroi me të meta që prishin magjinë dhe gënjeshtrat e tija, kështu që mes syve të tij shkruan "kafir" (ك ف ر), e lexon atë çdo besimtar, që di shkrim e lexim apo nuk di.

Dobi nga hadithi

1. Dalja e Dexhallit është një prej shenjave të mëdha të Kiametit.
2. Mëshira e të dërguarit, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, ndaj umetit të tij, për tërheqjen e vërejtjes prej tij.
3. Fitneja e Dexhallit do të jetë me parafytyrime, në fakt nuk janë të vërteta.
4. Mëshira e Allahut ndaj robërve të Tij i cili përshkroi Dexhallin në mënyrë që të njihet pavërtetësia e thirrjes së tij, kështu që shëmtoi fizionominë e tij, dhe shkroi mes syve të tij dispozitën mbi të.
5. Pohimi i kerameteve për besimtarët analfabet të cilët do ta lexojnë çfarë shkruhet në ballin e Dexhallit.

www.albislam.com

BESIMI NË MUXHIZET E PEJGAMBERËVE

HADITHI I NJËZET E TETË

Ebu Hurejra, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, përcjell se i dërguari i Allahut, -paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të-, ka thënë: "Secilit prej profetëve i është dhënë mrekulli të cilat i kanë besuar njerëzit, ajo që më është dhënë mua është shpallja prej Allahut, e shpresoj që të jemë me më tepër pasues ditën e Kiametit."[30]

Kuptimi i përgjithshëm i hadithit

Prej mëshirës së Allahut mbi robërit e Tij është se dërgoi profetë tek ta, për t'i ftuar në adhurimin e Tij, e prej mëshirës së Tij mbi këta profetë është se i përkrahi me mrekulli që tregojnë për vërtetësinë e profetësisë së tyre, pra, mrekullia është shenjë e vërtetësisë së pejgamberllëkut, është argument i dërgimit prej Allahut, po të mungonte mrekullia tek një profet, populli i tij do të kishte arritur ta përgënjeshtronte, dhe do arrinin të tjerët të supozojnë se janë profetë, pa kërkuar argument për vërtetësinë e tyre.

Në këtë hadithi dërguari, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, na rrëfen se të gjithë profetët erdhën tek popujt e tyre me argumente që vërtetojnë se janë profet. Dhe se i dërguari, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, posedon argumentin më të madh, me çfarë shpreson të jetë me më tepër pasues.

Profetët e mëhershëm erdhën me argumente të dukshme që kanë përfunduar me kohën e tyre, sikur që është mrekullia e ndarjes së detit për Musain, e cila ka përfunduar pasi që ka ndodhur, gjë e cila është transmetuar më pas tek ata të cilët nuk e kanë parë me sy e që nuk e kanë përjetuar, përkundër mrekullisë më të madhe (Kuranit Fisnik) që është një mrekulli e pafundë, është një argument i gjallë e prezent, sfida e tij ende vazhdon, në çdo kohë dalin mrekullitë e tija, gjë që ua mbyll gojën kritikëve.

[30] Transmeton Buhariu (6/182) hadithi me numër (4981). Dhe Muslimi (1/134) hadithi numër (152).

www.albislam.com

Dobi nga hadithi

1. Muxhizet janë argument që tregon për profetësinë.
2. Secili profet kishte muxhizen e vet tek populli i tij, që argumenton vërtetësinë e tij.
3. Mrekullia më e madhe e Muhamedit, alejhi selam, Kurani.
4. Prej mrekullive më të mëdha prej mrekullive të profetëve mrekullia e Muahmedit, alejhi selam, Kurani.
5. Mrekullitë e profetëve janë mrekulli konkrete që kanë përfundu me vdekjen e tyre.
6. Realizimi i dëshirës së të dërguarit, alejhi selam, të jetë njeriu me më shumë pasues.

www.albislam.com

ZBRITJA E ISAIT, ALEJHI SELAM

HADITHI I NJËZET E NËNTË

Ebu Hurejra, *Allahu qoftë i kënaqur prej tij*, përcjell se i dërguari i Allahut, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, ka thënë: "Betohem në dorën e të Cilit është shpirti im, jo shumë larg do të zbret mes jush Isai i biri i Merjemes, do të gjykojë njerëzit me drejtësi, do të thyejë kryqin, do të vrasë derrat dhe do të heqë xhizjen. Do të ketë bollëk parash dhe askush nuk do të pranojë të marrë prej saj."[31]

Kuptimi i përgjithshëm i hadithit

Njerëzit nuk kanë ra në mospajtime për një profet siç është rasti me Isain, alejhi selam. Feja çifute e fyen atë me fyerjet më të mëdha, feja e krishtere e ritën atë dhe e tepruan saqë supozuan se është zot. Sa i takonë fesë islame, ajo qëndroi në mes, e madhëroi atë po njëkohësisht edhe mohoi fjalët e çifutëve, e pa tepruar siç vepruan të krishterët, por thuhet: ai është rob dhe i dërguari i Allahut.

I dërguari Muhamed, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, në këtë hadith sqaroi se Isai, alehi selam, do të zbret pak para fundit të botës, që të jetë një argument për tri fetë.

Urtësia e zbritjes së tij pak para Kiametit, e jo edhe më herët, është se kjo kohë do të veçohet me dije të pakët e të rrallë, me injorancë të tepërt dhe të përhapur, e nuk do të ketë njeri më primar e më ambicioz për të bartur përgjegjësinë e ringjalljes së fesë, se sa Isai alejhi selam, për arsye të vlerës së tij të madhe dhe pozitës së tij të ndershme, pasi që ai u ngrit në qiell dhe nuk vdiq, e që tre fetë kanë mospajtime rreth tij, e nuk do të ketë njeri më të drejtë që do të gjykojë mes tyre, do të gjykon për vërtetësinë e fesë islame, dhe pavlefshmërinë e feve tjera, do ta thyen kryqin që është një fakt praktik i bindjeve të kota të

[31] Transmeton Buhariu (3/82) hadithi me numër (2222). Dhe Muslimi (1/135) hadithi numër (155).

www.albislam.com

krishterëve rreth kryqit, do ta mbyt derrin për të treguar kotësinë e fesë së krishtere të cilët e lejuan, do ta tërheq tatimin për ithtarët e librave, prej çifutëve dhe të krishterëve, për të treguar pajtueshmërin e tij me fenë islame në raport me ta.

Kështu që Allahu do i mjafton njerëzit me të, e do të shtohen bereqetet në tokë, e shtohen mirësitë, Allahu do të mbjell kënaqësinë në zemrat e njerëzve, nga ku do të ritet besimi në shpirtrat e tyre, atëkohë do të ec i pasuri me mallin e tij për sadakë, e nuk do të gjejë kush do ta pranojë.

Dobi nga hadithi

1. Zbritja e Isait para ditës së Kiametit është prej gjërave të konfirmuara të besimit.
2. Do gjykon tek njerëzit me sheriatin e Muhamedit, alejhi selam.
3. Do zhvlerëson fenë krishtere.
4. Do zhvlerëson fenë çifute.

FEJA ISLAME KA SHFUQIZUAR GJITHA FETË

HADITHI I TRIDHJETË

Ebu Hurejra, *Allahu qoftë i kënaqur prej tij*, përcjell se i dërguari i Allahut, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, ka thënë: "Betohem në Atë, që shpirti im është në dorën e Tij, secili që dëgjon për mua prej këtij umeti, qoftë çifut apo i krishterë, e vdes duke mos besuar në mua, dhe në atë që më është dhënë, vetëm se do të jetë prej banorëve të zjarrit".[32]

Kuptimi i përgjithshëm i hadithit

I dërguari, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, na sqaron në këtë hadith një prej shtyllave të besimit islam, që është dërgimi i profetit Muhamed, alejhi selam, për gjithë njerëzimin, qofshin ata arab apo jo arab, njerëz apo xhinë, pa dallim gjinie, pozite, që të gjithë janë të njejtë në obligueshmërin e të besuarit dhe të bindurit ndaj tij. S'ka shpëtim për askënd, që ka dëgjuar për të, që ka njohur thirrjen e tij, qoftë çifut apo i krishterë, e për më tepër pagan apo ateist.

Dobi të hadithit

1. Dërgimi i profetit është gjithëpërfshirës, për gjithë njerëzit.
2. Çdo fe që i ka paraprirë islamit është fe e shfuqizuar.
3. Kush nuk beson në të dërguarin, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, pasi të ketë dëgjuar për të, është në zjarr, nuk i bën dobi besimi që ka.

[32] Transmeton Muslimi (1/134) hadithi numër (153).

www.albislam.com

PREJ SHENJAVE TË MËDHA TË KIAMETIT

HADITHI I TRIDHJETË E NJË

Ebu Hurejra, *Allahu qoftë i kënaqur prej tij*, përcjell se i dërguari i Allahut, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, ka thënë: "Nuk do të ndodh Kiameti, deri sa të lind dielli nga perëndimi, e pasi që të lind nga perëndimi të gjithë njerëzit do të besojnë, mirëpo atë ditë: "atëherë nuk do t'i bëjë dobi askujt besimi i tij, nëse nuk ka besuar më parë, ose nuk ka bërë ndonjë të mirë, në besimin e tij." (En Am, 158).[33]

Kuptimi i përgjithshëm i hadithit

Lindja e dielit nga perëndimi është një prej ndodhive të mëdha, e cila kur të ndodh do t'i shtang e trishton të gjithë banorët e tokës. Ta dini se Kiameti do të vije, nuk ka dyshim në të, që të gjithë do ta besojnë kur të shohin këtë argument të qartë të cilin nuk mund ta ndryshojnë, por, kthimi dhe besimi i tyre në atë kohë nuk u bën dobi aspak, ngase Allahu nuk pranon pendimin e të penduarit e as keqardhjen e pishmanit të asaj kohe.

Dobi nga hadithi

1. Prej shenjave të mëdha të Kiametit është lindja e diellit prej perëndimi.
2. Mos pranimi i besimit të një jobesimtari, e as pendimit të mëkatarit pasi që të lind dielli prej perëndimit.

[33] Transmeton Buhariu (6/58) hadithi me numër (4635). Dhe Muslimi (1/137) hadithi numër (157).

www.albislam.com

XHENETI DHE XHEHENEMI

HADITHI I TRIDHJETË E DY

Ebu Hurejra, *Allahu qoftë i kënaqur prej tij*, përcjell se i dërguari, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, ka thënë: "Kur Allahu krijoi xhenetin, i tha Xhibrilit: Shko, dhe shikoe! Kështu që shkoi dhe shikoi çfarë ka në të, më pas u kthye dhe tha: O Zot! Betohem në Krenarinë Tënde, kushdo që do të dëgjon për të, do hyjë në të. Pastaj Allahu e rrethoi atë më vështirësi, e i tha: O Xhibril, shko dhe shikoe tani! Shkoi dhe e shikoi, pasi që u kthye, tha: O Zot! Betohem në Krenarinë Tënde, frikohem se nuk do të arrijë askush të hyjë në të. E kur Allahu krijoi zjarrin (xhehenemin), tha: O Xhibril, shko dhe shikoe. Shkoi dhe shikoi në të, pastaj u kthye dhe tha: O Zot! Betohem në Krenarinë Tënde, nuk ka për të dëgjuar askush për të, e të hyjë në të. E Allahu e rrethoi atë me epshe, e i tha: O Xhibril, shko dhe shikoe tani. Kështu që shkoi dhe e shikoi, pastaj u kthye dhe tha: O Zot! Betohem në Krenarinë Tënde, frikohem se nuk do të mbetet askush pa hyrë në të."[34]

Kuptimi i përgjithshëm i hadithit

I dërguari, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, në këtë hadith na rrëfen për krijimin e xhenetit dhe xhehenemit, se si Allahu pasi që krijoi ata dërgoi Xhibrilin, alejhi selam, që të shikon në to, për shkak vlerës dhe pozitës së lartë që ka Xhibrili, alejhi selam. Kur ai pa xhenetin dhe kënaqësitë në të, u betua se çdo kush që do të dëgjon për të, do të dëshiron të hyjë në të, e Allahu e rrethoi atë me vështirësi, që janë farzet e obligimet tjera fetare ndaj të cilave njeriu nuk anon që t'i kryejë ato.

Pastaj e urdhëroi Xhibrilin që të shikon në të përsëri, e kur shkoi dhe shikoi në të, pa se ishte e rrethuar me vështirësi, e kuptoi natyrshmërinë e të ftuarve që të hyjnë në të, në dashurinë ndaj rehatisë e mos angazhimeve, dhe urrejtjen e detyrave në të cilat ka vështirësi, u betua se frikohet se nuk do të arrijë askush të hyjë në të!

[34] Transmeton Ebu Davudi (4/236) hadithi me numër (4744). Shejh Albani e vlerësoi hasen (sahih ve daif Ebi Davud, 1/2).

www.albislam.com

Pastaj Allahu e urdhëroi që të shikon xhehenemin, shikoi në të, pa aty zjarrin e madh, u kthye tek Zoti e u përbetua se kushdo që dëgjon për të nuk do të hyjë në të, e Allahu e rrethoi atë me epshe, e Xhibrili, alejhi selam, e dinte animin e të ftuarve ndaj epsheve, pasi që shikoi epshet e mëdha me të cilat ishte i rrethuar xhehenemi, u përbetua, e u frikua se nuk do të mbetet askush pa mos hyrë në të.

Allahu i Madhëruar nuk e ndaloi atë nga betimi e as që mohoi mendimin e tij, me këtë u bë e dijshme se shumica e njerëzve do të hyjnë në zjarr për shkak mos durimit ndaj epsheve, dhe se pakica do të hyjnë në xhenet, për shkak durimit dhe mundimit në lënien e epsheve dhe veprimin e obligimeve.

Dobi nga hadithi

1. Emri (Rab) Zot është një prej emrave të Allahut.
2. Lejohet betimi në atributet e Allahut, siç është fjala e Xhibrilit, alejhi selam, "Betohem në Krenarinë Tënde".
3. Se xheneti dhe zjarri janë të krijuar, dhe se ata dyja ekzistojnë tani.
4. Xheneti ka vendin e vet, edhe zjarri ka vendin e vet, ne nuk e dimë vendndodhinë, por Allahu e di, dhe ata që kanë shikuar në të.
5. Veprimi i ndalesave e rënia në epshe është rrugë për në zjarr.
6. Zbatimi i detyrave fetare, përballimi i vështirësive të tyre është rrugë e xhenetit.
7. Shumica e njerëzve hyjnë në zjarr për shkak mosdurimit ndaj epsheve të tyre.
8. Pakica e njerëzve do të hyjë në xhenet, për durimin e tyre ndaj vështirësive.
9. Xhibrili, alejhi selam, është prej melaqeve të afërta, pasi Allahu e veçoi atë të shikon xhenetin dhe xhehenemin.

www.albislam.com

DIJA ABSOLUTE E ALLAHUT

HADITHI I TRIDHJETË E TRE

Ebu Musa el Eshari, *Allahu qoftë i kënaqur prej tij*, rrëfen e thotë: "Ishim me të dërguarin, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, në një udhëtim, kur ecnim përpjetë shprehnim tekbire, e ai na tha: "Mos mundoni veten tuaj, ngase ju nuk po i luteni një të cilit nuk dëgjon e që mungon, por, ju i luteni Dëgjuesit, Shikuesit, të Afërit. Më pas erdhi Aliu, e unë isha duke pëshpëritur fjalët: La havle ve la kuvete ila bilah (Ska lëvizje e as fuqi, pos (lëvizja e fuqia) e Allahut. Ai më tha: O Abdullah ibn Kajs, thuaj: La havle ve la kuvete ila bilah, kjo (fjali) është një thesar prej thesareve të xhenetit".[35]

Kuptimi i përgjithshëm i hadithit

I dërguari i Allahut, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, nuk linte asnjë rast ku ishte mundësia për t'i mësuar shokët e tij për një çështje prej çështjeve të fesë, vetëm se ua mësonte.

Edhe në këtë hadith është një shembull i mësimit të rastit, ku pa që shokët e tij praktikonin një prej udhëzimeve të tija në shprehjen e tekbireve gjatë ngjitjes në vende të larta si në male, kodrina etj, pos që ata ngrisnin zërat lartë, kështu që i dërguari, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, nuk i ndaloi ata nga tekbiret, por i ndaloi nga ngritja e tepërt e zërit, ua tërhoqi vërejtjen se nuk ka nevojë për një gjë të tillë, sepse Allahu edhe pse qëndron mbi Arsh, pos që dija e Tij përfshinë çdo gjë, dëgjon çdo gjë, sheh çdo send, prej Tij nuk fshehet asgjë, qoftë në tokë a në qiell, kështu që nuk ka arsye për ngritje të zërit, mjafton që Allahu të thirret me zemër e me gjuhë, që Allahu të dëgjon thirrjen e Tij, e t'i përgjigjet lutjeve të tija.

[35] Transmeton Buhariu (8/82) hadithi me numër (6384).

www.albislam.com

Dobi nga hadithi

1. Mohimi i çdo atributi që aludon në mangësi për Allahun e Madhërishëm, siç është mosdëgjimi apo mosdija.
2. Allahut i takojn atributet absolute si Dëgjimi e Shikimi.
3. Mohimi i atributeve të mangëta, nënkupton përosmërinë e të kundërtave, pra nga mohimi i mosprezencës nënktupohet pohimi i dijes së tij absolute, dëgjimit, e shikimit.
4. Afrimi me Allahun është afrim abstrakt, e jo dhe afrim i qenieve, që ka kuptimin se Allahu e di atë se çfarë njerëzit veprojnë, duke qëndruar Ai në Arsh.
5. Askush s'ka as fuqi e as mundësi të bën ndaj një krijese diç, pos me caktimin, vullnetin dhe fuqinë e Allahut.
6. Dija gjithëpërfshirëse e Allahut, e njohja e çdo gjëje.
7. Përkufizimi i fuqisë dhe vullnetit vetëm për Allahun, nuk nënkutpon detyrim, ngase Allahu u dha robërve fuqinë e veprimit, vullnet e dëshirë për të vepruar, kështu që ata me vullnetin e dhuruar bëjnë zgjedhjen, dhe me fuqinë e dhuruar ata veprojnë.
8. Vepra e mirë është një shkak i hyrjes në xhenet.

www.albislam.com

SHTYLLAT E ISLAMIT, IMANIT E IHSANIT

HADITHI I TRIDHJETË E KATËRT

Omeri, *Allahu qoftë i kënaqur prej tij*, transmeton dhe thotë: Një ditë, gjersa po qëndronim me Pejgamberin, *lavdia dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të*, përpara nesh u paraqit një njeri me rroba shumë të bardha dhe me flokë shumë të zinj. Tek ai nuk dukeshin shenjat e udhëtimit dhe askush nga ne nuk e njihte. U ul pranë Pejgamberit, lavdia dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, i mbështeti gjunjët e tij me gjunjët e Pejgamberit dhe i vendosi duart mbi kofshët e tij dhe tha:

"O Muhamed, më thuaj çfarë është Islami?". Pejgamberi, -*lavdia dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të*-, tha: "Islam është: të dëshmosh se nuk meriton askush të adhurohet me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhamedi është rob dhe Pejgamberi i Tij, të falësh namazin, të japësh zekatin, të agjërosh Ramazanin dhe të bësh haxhin në Qabe, nëse ke mundësi." (Njeriu) tha: "të vërtetën pohove." Ne u habitëm nga ajo që ai e pyeste e pastaj thoshte se (Pejgamberi) po pohonte të vërtetën.

Ai tha: "Më thuaj çfarë është Imani (besimi)?" Ai (Pejgamberi) u përgjigj, "të besosh Allahun, melekët e Tij, Librat e Tij, Pejgamberët e Tij, Ditën e Fundit dhe të besosh në Caktimin (kaderin), se e mira dhe e keqja vijnë prej Tij ." Ai tha: "të vërtetën pohove."

Dhe më pas tha: "Më thuaj çfarë është Ihsani (mirësia e përsosur)?" Ai u përgjigj: "Ai është, të adhurosh Allahun sikur të jesh duke e parë Atë, pasi edhe pse ti nuk e sheh Atë, Ai me të vërtetë të sheh ty."

Ai tha, "Më thuaj për Çastin se kur do të ndodhë?" Pejgamberi, -*lavdia dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të*-, u përgjigj: "I pyeturi nuk di më tepër sesa pyetësi."

www.albislam.com

Ai tha: "Më thuaj për shenjat kiametit." Ai iu përgjigj: "Robëresha do të lindë të zonjën e saj; dhe do t'i shohësh këmbëzbathurit, të zhveshurit e të varfërit, barinjë të dhenve duke bërë gara se kush ndërton më tepër ndërtesa të larta."

Pastaj, ai u largua, ndërkohë që unë qëndrova për shumë kohë. Pejgamberi, *lavdia dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të*, më tha: "O Omer, a e di kush qe pyetësi?" Unë i thashë: "Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më së miri." Ai tha: "Ai qe Xhibrili, dhe erdhi që t'ju mësojë fenë tuaj."[36]

Kuptimi i përgjithshëm i hadithit

Sahabët, *Allahu qoftë i kënaqur prej tyre*, kishin dëshirë të pyesin të dërguarin, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, duke mospëlqyer teprimin në të pyeturit. Ishte e çuditshme për ta, që një i huaj, të pyet të dërguarin, e ata t'i dëgjonin përgjigjet, përderisa sahabët ishin ulur me të dërguarin, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, duke mësuar dhe kuptuar fenë tek ai.

Hyri ky person i panjohur, nga i cili nuk vëreheshin shenja të udhëtimit, erdhi saqë u ul përballë të dërguarit të Allahut, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, filloi ta pyet dhe t'ia konfirmon përgjigjet e tija, gjë që i habiti sahabët nga ky veprim i këtij personi të huaj!

Megjithatë, ata dëgjuan me një qetësi të madhe atë që ai thoshte dhe përgjigjet nga i dërguari, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, ishin pyetje që kanë të bëjnë me themelet e fesë, e përgjigjet e të dërguarit ishin shumë të qarta, të mjaftueshme, e gjithëpërfshirëse.

E pyeti për imanin, e i dërguari ia tregoi shtyllat e tij,e pyeti për islamin, e i tregoi i dërguari, farzet e fesë, e pyeti për ihsanin i përmendi dy mënyrat e sqaroi dy shyllat e tij, në fund i huaji përfundoi pyetjet e tija, me peytjen rreth Kiametit, ku edhe përfundon kjo botë, kur njerëzit do të ringjallen për të dhënë llogari e për tu shpërblyer. U përgjigj i dërguari i Allahut, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, se nuk ka askush prej krijesave që di kohën se kur do të ndodhë, e personi e pyeti për shenjat e tij. Ai ia përmendi disa prej shenjave, si; marrja e robëreshave nga mbretërit që do të lindin fëmijë, të cilët më pas do të jenë zotërinj të nënave të tyre robëresha, e përmendi prej shenjave garimin e barinjëve, këmbëzbathur nga beduinët arab, në ndërtime, në këmbim të jetës së tyre në rrugëtime e

[36] Transmeton Muslimi (1/36) hadithi numër (8).

www.albislam.com

shpërngulje. Pas gjithë këtyre pyetjeve të thella, e përgjigjeve të qarta, u largua, e la në zemrat e atyre që dëgjonin prej sahabëve, disa mësime imanore shumë të rëndësishme. I dërguari i Allahut, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, nuk harroi që të largon habinë e tyre nga pyetjet e këtij të huaji, e u tregoi se ai pyetësi ishte Xhibrili, alejhi selam, kishte ardhur që t'ua mësonte fenë.

Dobi nga hadithi

1. Ky hadith sqaron se çështë islami, dhe se ai përfshin gjitha veprat e mira të mundushme, që prej shqiptimit të shehadetit, namazit, zeqatit, agjërimit e haxhit.
2. Sqaron se çështë imani, dhe se ai përfshiin gjitha veprat e brendshme, që prej besimit në Allahun, melaqet, librat, të dërguarit, ditën e Fundit, në kader qoftë për mirë apo për keq.
3. Besimi në Allahun nënkupton pohimi i ekzistimit të Tij, dhe se është i atribuar me atribute absolute, i pastër nga çdo atribut mangësie.
4. Besimi në melaqet nënkupton, pohimi i ekzistencës së tyre, dhe se ata janë ashtu siç Allahu i ka përshkruar, robër të ndershëm.
5. Besimi në të dërguarit nënkupton, pohimi se ata janë të dërguar prej Allahut, janë besnik në atë që ata rrëfejnë.
6. Besimi në librat që nënkupton, pohimi se janë fjalë të Allahut, dhe se çfarë ato përmbanin ishte e vërtetë.
7. Besimi në ditën e Fundit nënkupton, pohimi i ringjalljes pas vdekjes, llogarisë, peshores, xhenetit e xhehenemit.
8. Obligueshmëria e besimit në të gjitha shtyllat, pa dalluar mes tyre, përpos asaj që është veçuar me emërtime, në këtë rast duhet besuar në to veçmas. Si të besuarit në Musain, Isain, Harunin prej pejgamberëve, besimi në Tevratin, Inxhilin, e Kuranin. Të besuarit në Xhibrilin, Mikailin prej melaqeve.
9. Të besuarit në kader nënkupton, se Allahu ka qenë i dijshëm për përcaktimet e gjërave, për kohërat para se të krijohen, pastaj i krijoi, ato që në dijen e Tij ishte se do krijohet, kështu që çdo krijesë është burim i Dijes, Fuqisë dhe Dëshirës së Allahut.
10. Feja islame përmban tri shtylla kryesore: imanin, islamin dhe ihsanin.
11. Kuptimi i Ihsanit është: të ndjehet prania e mbikqyrjes së Krijuesit të Madhërishëm, me një bindje se Allahu atë e sheh, i di veprimet, gjendjet, nga ato që shfaqen dhe ato të fshehta.
12. Ky hadith sqaron se dija mbi Kiametin i takon vetëm Allahut, dhe se të dërguarit,melaqet e gjithë tjerët nuk kanë dijeni për kohën se kur do të ndodhë.
13. Kiameti njihet me ndodhinë e shenjave të tij.

www.albislam.com

FALLXHORËT

HADITHI I TRIDHJETË E PESË

Aisheja, *Allahu qoftë i kënaqur prej saj*, rrëfen: Disa njerëz pyetën të dërguarin ,-*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, për fallxhorët? Ai iu përgjigj: Ata, sjanë asgjë (fjalët e tyre janë të kota, nuk mbështete në to). Thanë: O i dërguari i Allahu! Ata flasin për disa gjëra, që në të vërtetë ndodhin. E i dërguari i Allahut, -paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të-, iu përgjigj: "Atë fjalë të vërtetë shejtani vjedhurazi e dëgjon, pastaj zbresin dhe u fryjnë falltarëve për këtë, duke i shtuar asaj edhe njëqind rrena të tjera nga vetja e tyre".[37]

Kuptimi i përgjithshëm i hadithit

Exhinët qëndronin në qiell për të dëgjuar atë që pështpërisnin melaqet, prej lajmeve të Allahut e urdhrave të Tija, këta ua përcillnin falltorëve atë që dëgjonin, të cilët këto lajme i përdornin për t'i nënshtruar njerëzit, për t'i devijuar e shkaktuar probleme tek ta.

Kur i dërguari i Allahut, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, u dërgua si profet tek njerëzimi, rojtarët e qiellit u shtuan edhe më shumë, saqë nuk mund të arrinte asnjë shejtan në dyert e tij, poqëse afrohej sulmohej me shigjeta të zjarrit, përkundër kësaj shejtanët ndërmirrnin mënyra të ndryshme për të marrë lajme nga gajbi, edhe nëse për këtë sakrifikonin veten, vetëm e vetëm për t'i devijuar njerëzit, e të vazhdojnë të kenë ndikim tek ta. Kështu shejtanët qëndronin njëri mbi tjetrin të hipur deri në qiell, ndoshta shigjeta e ka goditur atë që ka dëgjuar para se të përcjell atë që ka dëgjuar, e të digjet, e ndoshta nuk është goditur pos pasi që ka përcjellë lajmin tek tjetri që është ndër te, deri sa të arrijë në tokë, e i përcillet lajmi magjistarit, e atij lajmi ai ia shton edhe njëqind gënjeshtra, e njerëzit i besojnë e thonë: A nuk na tregoi atë ditë se do të ndodhë kështu e kështu, e vërtetë ajo edhe ndodhi, prej një fjale që ishte dëgjuar prej qielli.

[37] Transmeton Buhariu (7/136) hadithi me numër (5762).

www.albislam.com

Dobi nga hadithi

1. Tërheqja e vërejtjes nga fallxhorët, e të gjithë ata që i ngjajnë atij, prej atyre që pretendojnë se dijnë të fshehtën.
2. Sakrifikimi i shejtanëve dhe rrezikueshmëria e tyre për të njohur diç prej gajbit, për të devijuar bijtë e Ademit, e të shkaktojnë telashe tek ta.
3. Shkuarja tek fallxhorët është haram, për të njohur prej tyre gjërat e fshehta e të beson në to, ebu Hurejra, *Allahu qoftë i kënaqur prej tij*, përcjell se i dërguari, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, ka thënë: "Kush shkon tek një falltor, apo një parashikuesi, e beson në atë që thotë, ka bërë kufër në atë që i është zbritur Muhamedit, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-". Shënon Ahmedi.
4. Falltorët kanë shumë pakë fjalë të vërteta, e shumicën e tyre i kanë gënjeshtra.

www.albislam.com

SHEFATI I TË DËRGUARIT, ALEJHI SELAM

HADITHI I TRIDHJETË E GJASHTË

Enes ibn Maliku, *Allahu qoftë i kënaqur prej tij*, përcjell se i dërguari i Allahut, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, ka thënë: "Allahu do t'i grumbullojë njerëzit në ditën e Kijametit dhe ata do të brengosen për këtë (tubim) e do të thonë: sikur të kërkonim ndërmjetësim te Zoti ynë sa të na heqë nga vendi që ndodhemi. Tha: i shkojnë Ademit, O Adem! Ti je babai i njerëzimit, Allahu të ka krijuar me duart e Tij, ka fryrë te ti nga shpirti i krijuar, si dhe ka urdhëruar engjëjt të biejnë në sexhde ty, ndërmjetëso për ne te Zoti yt, a nuk e shikon se deri ku ka arritur çështja? E do të thotë: "Nuk jam unë për të, e do të përmend mëkatin e vet që ka vepruar, e do të turpërohet prej Zotit për atë mëkat, e u thotë: Shkoni te Nuhu.

Pasi që shkojnë tek Nuhu, alejhi selam, ai u thotë: Unë nuk jam për këtë, e do të përmend gabimin e tij që ka vepruar,e do të turpërohet para Zotit për atë mëkat, e u thotë: Shkoni tek Ibrahimi, alejhi selam, të cilin Allahu e konsideroi mik të Tij. Shkojnë tek Ibrahimi, alejhi selam, e ai u thotë: Unë nuk jam për këtë, e ua përmend gabimin që ka vepruar e turpërohet para Zotit për shkak të këtij gabimi, e u thotë: Shkoni tek Musai, alejhi selam, atij Allahu i foli, e ia dha Tevratin, kështu që shkojnë tek Musai, alejhi selam, e ai u thotë: Unë nuk jam për këtë, e do të përmend gabimin e tij, e turpërohet para Zotit për atë gabim, u thotë: Shkoni tek Isai, alejhi selam, që është Fjala prej Tij (Allahut), të cilën Ai e vendosi te Merjemja si shpirt i krijuar prej Tij, shkojnë tek Isai, e ai do të thotë: Unë nuk jam për këtë, por shkoni tek Muhamedi, alejhi selam, një rob që Allahu ia ka falur gabimet e mëhershme dhe ato të mëvonshme. dhe më vijnë mua e unë i kërkoj Allahut leje, kur e shikoj Atë, bie në sexhde dhe më lë kështu sa do Ai, pastaj më thuhet: ngrije kokën, kërko e do të të jepet, fol e do të dëgjohesh, ndërmjetëso e do të të lejohet ndërmjetësimi. E ngre kokën, falënderoj Zotin tim me fjalë që m'i mëson Ai, pastaj ndërmjetësoj dhe më vendos (cakton) një kufi (njerëzish), pastaj i nxjerr nga Zjarri dhe i fus në Xhenet, pastaj kthehem dhe bie në sexhde njëlloj, dhe më lë kështu sa do Ai, pastaj më thuhet: ngrije kokën, kërko e do të të

www.albislam.com

jepet, fol e do të dëgjohesh, ndërmjetëso e do të të lejohet ndërmjetësimi. E ngre kokën, falënderoj Zotin tim me fjalë që m'i mëson Ai, pastaj ndërmjetësoj dhe më vendos (cakton) një kufi (njerëzish), pastaj i nxjerr nga Zjarri dhe i fus në Xhenet, -transmetuesi deklaron (nuk e di se herën e tretë apo të katërtën tha), e them: O Zot! Nuk ka mbet askush në zjarr, veçse ai që e ka prangosur Kurani. (Pra ka merituar të qëndron për çdoherë)."[38]

Kuptimi i përgjithshëm i hadithit

Ditën e Kiametit, që është një ditë e vështirë, e mundimshme, njerëzit do të qëndrojnë në mahsher, e do të zbret dielli afër kokave të tyre, saqë njerëzit do të fundosen në djersët e tyre, për çfarë do të përjetojnë vuajtje, e lodhje të madhe, shpresojnë të përfundojë kjo gjendje, e nuk do të gjejnë rrugëdalje tjetër pos se të kërkojnë ndërmjetësim prej të dërguarve.

Kështu që fillojnë prej Ademit, alejhi selam, babait të njerëzimit, i cili e sheh veten në pozitë më të ulët për atë që ata kërkojnë, e shkojnë më pas tek Nuhu, e Ibrahimi, alejhi selam, pastaj tek Musai, e pastaj tek Isai, alejhim selam, i cili i udhëzon të shkojnë tek Muhamedi, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, i cili u thotë atyre: Unë jam për këtë, unë jam për këtë. I cili do të bie në sexhde për Allahun, e Allahu e inspiron me disa lutje që më herët askush nuk ka falënderuar Allahun në tokë, i pranohet ndërmjetësimi i tij, i urdhëron njerëzit që të gjithë të drejtohen për në llogari.

Allahu urdhëron robërit që të kalojnë urën e siratit, e disa prej umetit biejnë në zjarr, si shkak i mëkateve që kanë vepruar, e Allahu i jep leje të dërguarit, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, që të ndërmjetëson, e do të ndërmjetëson për çdo njeri i cili ka thënë: La ilahe il Allah, me sinqeritet buruar nga zemra e tij, qoftë edhe sinqeriteti i tij të arrijë sasinë e sa një kokre elbi.

Dobi nga hadithi

1. Ademi, alejhi selam, është i dërguari i parë.
2. Nuhi, alejhi selam është i dërguari i parë në tokë.
3. Lejimi i ndërmejtësimit me të dërguarit, për gjëra që ata kanë aftësi, gjatë jetës së tyre.
4. Pohimi i atributit të folurit për Allahun.

[38] Transmeton Muslimi (1/180) hadithi numër (193).

www.albislam.com

5. Turpërimi i të dërguarve prej Zotit, e madhërimi i tyre ndaj Tij.
6. Vlera e të dërguarit, Muhamedit, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, mbi të dërguarit e tjerë.
7. Pesë të dërguarit më të dalluar; Ademi, Nuhu, Ibrahimi, Musa, Isa dhe Muhamedi, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të- gjithë*.
8. Pohimi i ndërmjetësimit për të dërguarin, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, siç është shefati për të ndërprerë gjykimi, shefati për të hapur derën e xhenetit, ndërmjetësimi për të nxjerrë nga zjarri mëkatarët besimdrejtë.
9. Mekamu mahmud, që i është premtuar prej Allahut, të dërguarit të Tij, është shefati i tij për të filluar gjykimin mbi njerëzit ditën e Kiametit.
10. Besimtarët e drejtë prej umetit do të shpëtojnë nga përjetshmëria në zjarr, dhe se në zjarr nuk qëndron përgjithmonë asnjë besimdrejtë.
11. Mëshira e Allahut për këtë umet, dhe vlera e tij mbi umetet tjera.

www.albislam.com

HALLI I MËKATARËVE DITËN E KIAMETIT

HADITHI I TRIDHJETË E SHTATË

Enes ibn, Maliku, *Allahu qoftë i kënaqur prej tij*, përcjell se i dërguari, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, ka thënë: "Disa njerëz do t'i godet flaka e zjarrit, për shkak ndëshkimit për mëkatet e vepruara, më pas Allahu i fut ata në xhenet, me mirësinë e mëshirën e Tij, ata quhen: xhehenemijun".[39]

Kuptimi i përgjithshëm i hadithit

I dërguari, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, përmend në këtë hadith fatin e disa mëkatarëve ditën e Kiametit, të cilët do të urdhërohen të hyjnë në zjarr, e i godet ata flaka e zjarrit, me nxehtësinë e saj lë gjurmë në fytyrat e tyre, e do të hyjnë në zjarr, do të qëndrojnë aty për një kohë, pasi që të jenë pastruar prej mëkateve, Allahu urdhëron të nxirren prej zjarri, e të futen në xhenet, e banorët e xhenetit këta do t'i thërrasin 'xhehenemijunë', për nga vendi prej ku kanë dalur.

Dobi nga hadithi

1. Mëkatarët ditën e Kiametit nuk janë të njejtë, prej tyre ka që Allahu i falë, e prej tyre ka që do të dënohen në zjarr të xhehenemit, për një kohë.
2. Allahu do të nxjerr nga zjarri disa prej mëkatarëve, me mëshirën e Tij, këta quhen 'xhehenemijunë', apo të liruarit e Allahut, siç janë përmendur në disa hadithe tjera.
3. Mëkatari përfundon në xhenet, edhe pse për një kohë qëndron në xhehenem, ai nuk është përgjithmonë në zjarr.
4. Mëkatarët që meritojnë dënimin ditën e Kiametit janë ata që kanë vepruar mëkate të vazhdueshme, e nuk janë penduar prej tyre.
5. Mëshira e Allahut ështhtë shkak i çdo mirësie, në dynja apo ahiret.
6. Nuk ka asgjë obligative për Allahun e Madhëruar përballë robërve të Tij, pos atë që Ai vetë e merr si obligim.

[39] Transmeton Buhariu (9/134) hadithi me numër (7450).

www.albislam.com

KËNAQËSIA E MË E MADHE NË XHENET

HADITHI I TRIDHJETË E TETË

Suhejb er Rumi, *Allahu qoftë i kënaqur prej tij*, përcjell se i dërguari i Allahut, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, ka thënë: "Pas që banorët e xhenetit të hyjnë në xhenet, Allahu i Madhëruar e i Lartësuar u thotë atyre: A dëshironi diç më tepër? E do të thonë: A nuk na i zbardhe fytyrat tona? A nuk na fute në xhenet e na shpëtove nga zjarri? I dërguari, -paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të-, thotë: E Allahu hjek perdern, e atyre nuk u është dhënë diç më madhështore, e më të dashur se sa të shikojnë në Zotin e tyre, aze ve xhel".[40]

Kuptimi i përgjithshëm i hadithit

I dërguari, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, në këtë hadith na flet çër një dhunti madhështore prej të cilave Allahu begaton banorët e xhenetit, e që është shikimi në Fytyrën e Allahut të Lartësuar.

Pasi që Allahu do t'i pyet robërit e tij në xhenet, a doni diç më tepër? E ata do i shohin gjitha ato begati, pasi që Allahu zbardhi fytyrat e tyre, i futi ata në xhenet, ua dhuroi kënaqësinë e Tij mbi ta, e çfarë të shpresojnë më pas? E i befason ata Allahu me atë që nuk e kishin paramenduar, zbulon Fytyrën e Tij, kështu që për ata shikimi në Të, është prej dhuntive më të mëdha dhe më të dashura.

Dobi nga hadithi

1. Besimtarët do ta shohin Zotin në xhenet, dhe kjo dhunti është prej dhuntive më të mëdha.
2. Pohimi i të folurit për Allahun, dhe se Allahu do të flet me robërit e Tij, e do e kuptojnë Atë pa ndërmjetësues.

[40] Transmeton Muslimi (1/163) hadithi numër (181).

www.albislam.com

3. Shikimi i besimtarëve në Allahun, që ndodh në xhenet, nuk mohon shikimin në Allahun edhe në vende tjera, siç argumenton për këtë fjala e Allahut: "Jo, jo, atë ditë, me të vërtetë, ata do të jenë të penguar që ta shohin Zotin e tyre." Mutafifin, 15. Pra, ky ajet tregon se besimtarët do e shohin Zotin ditën e Kiametit.
4. Shikimi i besimtarëve në Allahun në xhenet, është shikimi vazhdueshëm, jo i rastësishëm, atyre u përcaktohet dita e xhuma që ta shohin Allahun, banorët e xhenetit këtë ditë do e quajnë: ditë e shtimit (shtimit të dritës në fytyrate tyre), siç është transmetuar në disa hadithe.

www.albislam.com

BAZENI I TË DËRGUARIT, ALEJHI SELAM

HADITHI I TRIDHJETË E NËNTË

Enes ibn Maliku, *Allahu qoftë i kënaqur prej tyre*, përcjell se i dërguari i Allahut, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, ka thënë: "Gjerësia e Haudit (bazenit) është sa largësia ndërmjet Ajles (qytet në Siri) e San'asë në Jemen, dhe aty ka ibrikë aq sa numri i yjeve në qiell".[41]

Kuptimi i përgjithshëm i hadithit

I dërguari, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, përgëzon me këtë hadith umetin e tij, për një mirësi prej mirësive me të cilat Allahu do, e veçon të dërguarin e Tij ditën e Kiametit, e që është Haudi të cilin ai nuk do e mban për vete, por aty do e fton umetin e tij, nga ku do të pijë ujë çdo besimtar e besimtare, e do të pegohet nga pirja çdo jobesimtar, njeri i ligë apo bidatçi.

I dërguari, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, e përshkruan gjerësinë e bazenit, sa një hapësirë mes Ajles, që është një qytet në Sham, dhe San'asë, një qytet i njohur në Jemen, mes tyre ka hapësirë ecje një muaj, dhe se numri i gotave është sa numri i yjeve në qiell, që nënkupton se janë për aq në numër, apo është për qëllim për nga numri i madh, këta numra tregojnë se ata që do të pijnë aty do të jenë shumë, e kushdo që do të pijë aty, më nuk do të etet asnjëherë.

Dobi nga hatithi

1. Vlera e të dërguarit, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, duke u veçuar me këtë bazen të madh.
2. Çdo i dërguar do të ketë bazenin e tij, pos që bazeni i të dërguarit, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, është më i madh, Semure, *Allahu qoftë i kënaqur prej*

[41] Transmeton Buhariu (8/119) hadithi me numër (6580).

www.albislam.com

tij, përcjell se i dërguari i Allahut, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-,ka thënë: "Vërtetë, çdo i dërguar do të ketë Haudin e tij, dhe ata do të krenohen se cili prej tyre ka më shumë burime, e unë shpreson të jemë me më shumë se ata". Shënon Trimidhiu

3. Përshkrimi i Haudit, se është i gjërë, me shumë gota, shumë i dobishëm për pirje, kushdo që pinë aty nuk do të etet asnjëherë.
4. Ky Haud është i përcaktuar vetëm për pasuesit e të dërguarit, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, e nuk kanë hise ata që mohuan, apo ndryshuan sunetin e tij e pasuan epshet e tyre, Enes ibn Maliku, *Allahu qoftë i kënaqur prej tij*, përcjell se i dërguari, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, ka thënë: "do më afrohen disa njerëz prej shokëve të mi, saqë do t'i njoh se kush janë, e ata do të largohen prej mua, e do të them: "Ata janë shokët e mi! E më thuhet: Ti nuk e di se çfarë vepruan ata pas vdekjes tënde". Shënon Muslimi.

   Shokët e mi ka për qëllim çdo secili prej atyre që e ka parë dhe ka besuar në të, por që më pas ka ndryshuar pas vdekjes së të dërguarit, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, siç është rasti i disave që kanë refuzuar të japin zeqatin, të cilët i ka luftuar Ebu Bekri, *Allahu qoftë i kënaqur prej tij*.

5. Haudi do të jetë në ditën e Kiametit para Siratit, për arsye se aty do të ndalohen të pijnë njerëzit që kanë dalë prej fesë, e të tillët nuk do e kalojnë Siratin.
6. Haudi nuk është Keutheri, sepse Haudi do të jetë ditën e Kiametit, e Keutheri është lum në xhenet, por që prej xheneti do derdhen dy kanale prej lumenjëve të xhenetit në Haud, siç ka treguar i dërguari, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-.
7. Është përshrkuar në hadithet e të dërguarit, -*paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të*-, se uji i Haudit do të jetë më i bardhë sesa qumështi, e do të jetë më i ëmbël sesa mjalti, siç qëndron në hadithin e saktë shënuar nga Muslimi e të tjerë.

Fund

www.albislam.com

Përmbajtja

KRIJIMI I GJITHËSISË 2
ISLAMI FE E NATYRSHMËRISË NJERËZORE 4
TEUHIDI, OBLIGIMI I PARË PËR NJERËZIMIN 6
VLERA E TEUHIDIT 8
MËKATI MË I MADH E MË I SHËMTUAR 9
CILËSITË E HAVARIXHËVE 11
BESIMI NË KADER 13
POZITA E VEPRAVE PREJ IMANIT 15
IMANI PAKOHET ME MËKATE 16
VARRI - VENDBANIMI I PARË I AHIRETIT 18
A E PA PROFETI, ALEJHI SELAM, ALLAHUN ?! 23
DYSHIMET RRETH BESIMIT 24
FATI I VEPRAVE TË JOBESIMTARËVE PAS VDEKJES 26
FUQIA ABSOLUTE E ALLAHUT 27
ZHDUKJA E IMANIT 29
KUR VIJE FUNDI I BOTËS 30
KURANI, FJALË E ALLAHUT 31
ÇDO GJË FUNKSIONON ME LEJEN DHE DËSHIRËN E ALLAHUT 33
POHIMI SE ALLAHU FLET 34
ATRIBUTET E ALLAHUT NË SUREN IHLAS 36
ÇELËSAT E GAJBIT 39
PËRJETSHMËRIA E BANORËVE TË XHENETIT DHE BANORËVE TË ZJARRIT 41
BESIMI I SINQERTË 43
MIQËSIMI ME BESIMTARËT 45
NDËRMJETËSIMI DHE DALJA E BESIMTARËVE NGA ZJARRI 46
VLERA E SHOKËVE TË PROFETIT, ALLAHU QOFTË I KËNAQUR PREJ TYRE 48
KU ËSHTË ALLAHU? 50

www.albislam.com

DEXHALLI 52
BESIMI NË MUXHIZET E PEJGAMBERËVE 54
ZBRITJA E ISAIT, ALEJHI SELAM 56
FEJA ISLAME KA SHFUQIZUAR GJITHA FETË 57
PREJ SHENJAVE TË MËDHA TË KIAMETIT 58
XHENETI DHE XHEHENEMI 60
DIJA ABSOLUTE E ALLAHUT 62
SHTYLLAT E ISLAMIT, IMANIT E IHSANIT 65
FALLXHORËT 67
SHEFATI I TË DËRGUARIT, ALEJHI SELAM 69
HALLI I MËKATARËVE DITËN E KIAMETIT 70
KËNAQËSIA E MË E MADHE NË XHENET 71
BAZENI I TË DËRGUARIT, ALEJHI SELAM 73

www.albislam.com